



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 593 Akti

**Nr. 624 Vendimi
Tiranë, më 20.02.2023**

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Pamela Qirko	Kryesuese
Roland Ilia	Relator
Brunilda Bekteshi	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Amela Idrizi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Marie Tuma, në datën 16.2.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:	Z. Asllan Barjamaj , me detyrë Prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Përmet.
OBJEKTI:	Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.
BAZA LIGJORE:	Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë , miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar; Ligji nr. 84/2016 , “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; Ligji nr. 44/2015 , “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; Ligji nr. 49/2012 , “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionerin Roland Ilia, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Asllan Barjamaj, i cili në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Asllan Barjamaj, me detyrë Prokuror pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni).
2. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).
3. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni ka hedhur shortin në muajin Qershor të vitit 2020, në përfundim të të cilit rezultoi që, subjekti i rivlerësimit Asllan Barjamaj do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues, i përbërë nga komisionerët Pamela Qirko, Roland Ilia dhe Brunilda Bektashi. Relator i çështjes u zgjodh me short komisioner Roland Ilia. Ndërsa kryesuese e trupit gjykues u caktua me mirëkuptim, komisionere Pamela Qirko. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit. Më pas u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Asllan Barjamaj, sipas nenit 45 të ligjit 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve e rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit.
4. Subjektit të rivlerësimit iu komunikua në rrugë elektronike përbërja e trupit gjykues, duke iu bërë me dije e drejta për tu shprehur në lidhje me konfliktin e interesit. Subjekti i rivlerësimit, sipas kërkesës së Komisionit ka deklaruar mungesën e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.
5. Në vijim, relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm për të tre kriteret e vlerësimit: të pasurisë, të kontrollit të figurës, si dhe të vlerësimit të aftësive profesionale.
6. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pas përfundimit të hetimit të thelluar administrativ për të tria kriteret e vlerësimit - vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale, në datën 3.2.2023, vendosi (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit Asllan Barjamaj; (ii) njoftimin e subjektit për t’u njohur me materialet e dosjes; si dhe (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.
7. Subjekti i rivlerësimit bashkë me njoftimin mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni, u njoftua edhe me vendimin e ndërmjetëm¹ të Komisionit në lidhje me kërkesat e tij me karakter procedural. Subjekti i i rivlerësimit ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja, të cilat i paraqiti në rrugë zyrtare pranë Komisionit më datë 13.2.2023.

¹ Vendimi nr.***, datë 14.2.2023 i Trupës gjyqëse të KPK-së.

8. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim dhe i analizoi shpjegimet e paraqitura dhe provat mbështetëse mbi rezultatet e hetimit, vendosi të ftojë z. Asllan Barjamaj në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

II. SEANCA DËGJIMORE

15. Subjekti i rivlerësimit Asllan Barjamaj u ftua në seancë dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht me *e-mail*, në datën 14.2.2023.

16. Seanca dëgjimore me subjektin u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 16.2.2023, ora 09:45, në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0, Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar.

17. Subjekti i rivlerësimit mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe për të parashtruar shpjegimet dhe opinionet e tij në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit Asllan Barjamaj kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

18. Z. Asllan Barjamaj ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ ka zbatuar me përpikmëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur i janë kërkuar. Subjekti ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

19. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

20. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

20.1 Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

20.2 Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

20.3 Ndërsa, sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016 parashikohet objekti i rivlerësimit të aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

21. Referuar vendimit nr. 2/2017² të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

22. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* dhe deklaratat periodike vjetore të dorëzuara ndër vite, nga subjekti në ILDKPKI;
- ç) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- d) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja;
- dh) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja;
- e) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

23. Bazuar në ligjin nr.76/2016, datë 22.7.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.84/17, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe në ligjin nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, përfundoi kontrollin e plotë të deklaratës së pasurisë, dhe në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, konstatohet se për subjektin Asllan Barjamaj:

- **deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin,**
- **ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;**
- **nuk ka kryer fshehje të pasurisë;**
- **nuk ka kryer deklarim të rremë;**
- **subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.**

Asllan Barjamaj, është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2007 me numër indeksi *** dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, dt. 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive,

²“41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: ‘Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit’. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: ‘Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë’. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar dhe të ligjit nr. 9367, dt. 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, ka dorëzuar ndër vite deklaratat e interesave privatë: *Para fillimit të detyrës 2007; Periodike/Vjetore 2007-2017 dhe Deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar, Vetting.*

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

25. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; c) provat shkresore/dokumentet të/e administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; ç) deklaratimet e subjektit me anë të komunikimit elektronik dhe d) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit.

26. Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni nisi shqyrtimin e deklarimeve të interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë te ky institucion, duke i krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit Asllan Barjamaj, pas shqyrtimit të të dhënave të deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, dorëzuar më datë 30.1.2017 nga subjekti i rivlerësimit; krahasimit të deklaratave të pasurive të dorëzuara në ILDKPKI për periudhën 2007-2016, në raport me të dhënat në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*; shqyrtimit të të dhënave nga të gjitha bankat e nivelit të dytë, institucionet financiare dhe jofinanciare, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, organet tatimore, organet e tjera shtetërore, personat juridikë, individët, si dhe likuiditeteve - gjendje *cash* dhe hetimit të kryer lidhur me të dhënat e vetëdeklaruar nga subjekti gjatë plotësimit të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni.

Në deklaratën e pasurisë *Vetting*, të dorëzuar në ILDKPKI, subjekti i rivlerësimit Asllan Barjamaj ka deklaruar pasuritë si vijojnë:

1. Apartament në qytetin e Fierit

1.1 Subjekti ka deklaruar pasurinë apartament me vendndodhje në Fier, me sipërfaqe 89 m² me ambientet e përbashkëta. Vlera 45,000 euro. Pjesa takuese 50%.

1.2 Burimi i krijimit:

- a) 4,160,000 lekë marrë kredi bankare në Raiffeisen Bank, me datë 10.6.2016;
- b) 5,000 euro nga kursimet e tij dhe të bashkëshortes;
- c) 10,000 euro marrë borxh me kontratën e datës 8.6.2016, nga individi B.Z.

1.3 Sipas çertifikatës për vërtetim pronësie të datës 26.5.2016, (lëshuar nga ASHK) rezulton se pasuria apartament me sip 87 m², është regjistruar në emër të subjektit dhe bashkeshortes se tij E.B. Kjo pasuri sipas kartelës përkatëse është bllokuar në favor të palës shitëse shoqërisë “***”, deri në likuidimin e plotë të vlerës se shit-blerjes se saj nga pala blerëse.

1.4 Kjo pasuri apartament është blerë me kontratën e datës 23.5.2016 “Kontratë shitblerje pasurie të paluajtshme me kusht”³, me palë blerëse Asllan Barjamaj dhe me palë shitëse,

³Kontratë nr. *** rep, nr. *** kol, dt. 23.5.2016 si dhe Çertifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, dt. 26.5.2016, për pasurinë e llojit apartament me sip. 87m², me nr. pasurie ***, regjistruar në emër të Asllan dhe E.B; Kartela e pasurisë dhe Harta treguese e regjistrimit.

shoqëria “***” sh.p.k.. Vlera e blerjes së pasurisë rezultoi në shumën 45,000 euro, shumë e cila sipas kontratës do të likujdohet:

- a) *Kësti i parë 1,000 euro, paguar nëpërmjet Credins Bank;*
- b) *Kësti i dytë 9,000 euro, do të paguhet përpara lëvrimin të kredisë dhe*
- c) *Kësti i tretë dhe i fundit prej 35,000 euro do të paguhet me kredi në Raiffeisen Bank.*

1.5 ZVRPP, Fier konfirmon⁴ se subjekti Asllan Barjamaj ka në pronësi pasurinë me nr. ***, apartament me sip. 87 m², Fier.

Mënyra dhe burimi i blerjes së kësaj pasurie.

1.6 Për blerjen dhe likuidimin e kësaj pasurie palët kontraktuese kanë lëshuar dhe një deklaratë noteriale me nr. *** rep., e nr. *** kol., dt. 6.6.2016. Me anë të kësaj deklarate palët konfirmojnë se:

- *Kanë lidhur një kontratë shitblerje me kusht për blerjen e një apartamenti me sip. totale 87 m², kundrejt një çmimi total 45,000 euro, me çmim shitje 517,24 euro/m².*
- *Kjo kontratë të jetë me kusht përsa i përket mënyrës së pagesës së çmimit të shitjes. Është rënë dakord që pjesa e përfituar me kredi do të jetë në vlerën 30,000 euro. Kjo shumë nuk sjell ndryshime në çmimin total të pasurisë objekt kontrate, por vetëm në kështet që do të paguhet nga pala blerëse duke ndryshuar klauzolat e kontratës që lidhen me pagesën si më poshtë:*
- ***Kësti i parë** në ditën e lidhjes së kontratës shitje me kusht, pala blerëse deklaron se, ka paguar shumën prej **1,000 euro**, pranë Credins bank, sipas mandat arkëtimit përkatës.*
- ***Diferenca në shumën 14,000 euro** do të paguhet me këste për një afat deri një javë nga data e deklaratës, para disbursimit të kredisë.*
- ***Kësti përfundimtar në shumën 30,000 euro** do të likuidohet me çeljen e kredisë pranë Raiffeisen Bank, brenda afatit prej 2 muaj.*

1.7 Në DPV-në e vitit 2016, lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie subjekti ka deklaruar se, 4,160,000 lekë janë marrë kredi bankare në Raiffeisen Bank me kontratën e datës 10.06.2016, 10,000 euro marrë borxh me kontratën e datës 08.06.2016 nga person fizik dhe shuma tjetër nga kursimet e mëparshme.

1.8 Me mandat depozitimi në Raiffeisen Bank, në dt. 23.5.2016, rezultoi se, subjekti ka kaluar në llogarinë e noteres L.SH, shumën prej 1,001 euro, me përshkrimin “Derdhje për blerje shtëpie”.

1.9 Sipas dokumentave⁵, nga Raiffeisen Bank rezultoi dhe transferimi i shumës prej 554,000 lekë më dt. 6.6.2016, nga llogaria e b/shortes së subjektit, në llogarinë e noteres me përshkrim “kalim sipas kontratës shitblerje nr. *** rep, e nr. *** kol, kësti i dytë”.

⁴ Shih shkresën *Kthim përgjigje të ZQRPP me nr. *** prot., datë 27.9.2017* tek dosja e ILDKPKI-së.

⁵ Bashkëlidhur dokumentacionit të dorëzuar pranë ILDKPKI-së dhe përgjigjes nga RFZ bank tek hetimi i Komisionit “Nxjerrje llogarie” dhe “Pagesë e brendshme”.

1.10 Me anë të kontratës së huadhënies nr. *** rep, nr. *** kol, dt. 8.6.2016⁶, huadhënësi B.Z, i ka dhënë subjektit shumën 10,000 euro, me qëllim blerje apartamenti⁷. Afati i shlyerjes së huasë është 3 vjet, deri në dt.7.6.2018.

1.11 Me anë të kontratës së kredisë bankare, me nr.*** rep, nr. *** kol, dt. 10.6.2016, është përfituar kredia në shumën 4,160,000 lekë, me qëllim “blerje apartamenti”. Për këtë kredi bankare është vendosur si kolateral po ky apartament i blerë nga subjekti.

1.12 Për blerjen e këtij apartamenti në mënyrë të përmbledhur rezultuan:

- Më datë 23.05.2016 depozitim prej 1,000 euro, në llogarinë e noteres; Më datë 6.6.2016 kalim vlere 554,000 lekë (4,000 euro) nga llogaria e b/shortes në llogarinë e noteres;
- Më datë 8.6.2016 kalim vlere prej 10,000 euro nga llogaria e b/shortes në llogarinë e noteres;
- Më datë 20.6.2016 kalim vlere prej 4,140,000 lekë, nga llogaria e b/shortes në llogarinë e noteres.

Duket se, deri më datë 20.6.2016 është shlyer e gjithë vlera për blerjen e kësaj pasurie apartament nga subjekti dhe bashkëshortja.

Analiza e burimeve të blerjes së pasurisë - apartament.

1.13 Me qëllim sqarimin dhe provueshmërinë e mundësisë së kryerjes së pagesave për blerjen e apartamentit, u pyet subjekti⁸, në lidhje me burimin e pagesave të kryera për blerjen e apartamentit në shumën 1,000 euro dhe 554,000 lekë.

1.14 Subjekti në përgjigje të pyetsorit nr.*** deklaroi se:

➤ *Shumat 1,000 euro dhe 554,000 lekë përkatësisht derdhur në datat 23.05.2016 dhe 6.6.2016 në llogari të noteres, janë të ardhura siguruar, pjesërisht nga një kredi konsumatore marrë në vitin 2015, në shumën e 250.000 mijë lekëve si dhe kursimet e tij dhe bashkëshortes nga të ardhurat nga pagat.*

➤ *Shuma prej 1,000 euro ka burim të ardhurat nga kursimet dhe është derdhur më datë 23.05.2016 në llogari të noteres L.SH.*

➤ *Bashkëlidhur subjekti ka pasqyruar nga llogaria në Raiffiesen Bank, veprimin ku tregohet kalimi i shumës prej 554,000 lekë datë 23.05.2016 dhe fakti që kjo shumë ka qënë në llogarinë e tij bankare dhe një pjesë ka ardhur nga llogaria e bashkëshortes.*

1.15 Në lidhje me mundësitë e kryerjes së pagesave për blerjen e apartamentit në lagjen “***”, Fier, Komisioni analizoi si më poshtë:

1.16 **Kësti i parë** në vlerën 1,000 euro, depozituar nga subjekti, më datë 23.05.2016 me burim të ardhurat nga kursimet. Për këtë shumë është analizuar mundësia e subjektit dhe b/shortes për krijimin e kësaj shume bazuar në kursimet nga pagat e vitit 2016, deri në datën e depozitimit (23.05.2016).

⁶ Shih dokumentacionin në dosjen e ILDKPKI-së.

⁷ Bashkëlidhur dok të ILDKPKI-së gjendet *Urdhër-xhirim në Credins Bank, për transferimin e shumës 10.000 euro në dt. 8.6.2016, nga B.Z për Asllan Barjamaj.*

⁸ Shih pyetsorin nr. 2 drejtuar subjektit të rivlerësimit.

Analiza e mundësisë së pagesës së kestit 1,000 euro - 23.05.2016

Pershkrimi	Vlera
Të ardhura nga paga subjekti 01.01.16 - 23.05.16	476,049
Të ardhura nga paga b/shortja 01.01.16 - 23.05.16	221,660
Të ardhura totale 01.01.16 - 23.05.16	697,709
Shpenzime jetese 01.01.16 - 23.05.16	391,820
Shpenzime kredie 01.01.16 - 23.05.16	89,783
Shpenzime qiraje 01.01.16 - 23.05.16	60,000
Shpenzime totale 01.01.16 - 23.05.16	541,603
Ndryshim likuiditeti 31.12.15 - 23.05.16	56,879
Paguar kësti I per apartament 1,000€	135,270
Pamundësia financiare	-36,043

1.17 Nga analiza financiare, rezultoi se subjekti dhe b/shortja e tij kishin një pamundësi financiare në shumën prej -36,043 për të krijuar të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e shumës prej 1,000 euro në datë 23.05.2016, shtimin e likuiditeteve dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera të periudhës.

1.18 Kësti i dytë në vlerën 554,000 lekë, kaluar me datë 6.6.2016, me burim të ardhura të siguruara pjesërisht nga kredi konsumatore marrë në vitin 2015 në shumën 250,000 lekë dhe kursimet e subjektit dhe bashkëshortes.

1.19 Është verifikuar lëvizja e llogarive të subjektit dhe b/shortes së tij tek Raiffeisen Bank dhe ka rezultuar se, në llogarinë e b/shortes së subjektit, kalojnë shuma të ndryshme nga llogaria e pagës së subjektit. Këto vlera financiare kanë si burim të ardhurat nga pagat e subjektit, si edhe overdrafti që ka subjekti pranë RFZ Bank. Në datën 6.6.2016, gjendja para transfertës së llogarisë në emër të E.B ishte 554,010 lekë.

1.20 Pas analizimit të të gjitha lëvizjeve bankare të subjektit dhe b/shortes së tij, Komisioni konstatoi se, burim i pagesës së kestit 554,000 lekë (4,000 euro) janë të ardhurat nga pagat dhe overdrafti. Mbi këtë konstatim u hartua dhe analiza financiare si më poshtë.

Analiza e mundësisë së pagesës së kestit 554,000 lekë - 06.06.2016

Pershkrimi	Vlera
Të ardhura nga paga subjekti 23.05.16 - 06.06.16	92,457
Të ardhura nga paga b/shortja 23.05.16 - 06.06.16	44,332
Të ardhura totale 23.05.16 - 06.06.16	136,789
Shpenzime jetese 23.05.16 - 06.06.16	39,182
Shpenzime kredie 23.05.16 - 06.06.16	17,974
Shpenzime qiraje 23.05.16 - 06.06.16	12,000
Shpenzime totale 23.05.16 - 06.06.16	69,156
Ndryshim likuiditeti 23.05.16 - 06.06.16	-524,238
Paguar kësti II për apartament dt.06.06.16	554,000
Mundësia financiare	37,871

1.21 Nga analiza financiare, rezultoi se, subjekti dhe b/shortja kishin burime të ligjshme për pagesën e këstit në vlerën 554,000 lekë me dt.6.6.2016 dhe mbulimin shpenzimeve të periudhës nga data 23.5.2016 (datë kur është paguar kësti i parë prej 1,000 euro) deri në datën 6.6.2016.

1.22 Kësti i tretë në vlerën 10,000 euro, kaluar nga llogaria e A. Barjamaj tek Raiffeisen Bank në favor të noteres L. Sh. me dt. 8.6.2016.

1.23 Në deklaratën veting dhe në Dpv-në e vitit 2016 (vit i blerjes së apartamentit), subjekti deklaroi si burim të vlerës 10,000 euro, borxh me kontratën nr. *** rep., datë 8.6.2016, nga person fizik.

1.24 Subjekti ka depozituar pranë ILDKPKI-së: Kontratë huadhënie nr. *** rep, nr. *** kol, dt. 8.6.2016, me huamarrës Asllan Barjamaj dhe huadhënës B.Z për shumën 10,000 euro, me qëllim blerje apartamenti⁹. Në këtë kontratë, huadhënësi deklaroi se, këtë shumë e disponon nga të ardhurat e përfituara nga aktiviteti i tij si dhe të ardhurat familjare.

1.25 Është pyetur subjekti për mundësitë e huadhënësit B.Z për dhënien hua të shumës 10,000 euro në vitin 2016, si dhe përse kjo hua prej 10,000 euro, rezultoi akoma e pashlyer nga ana e subjektit.

1.26 Në përgjigje të pyetsorit nr.***, subjekti ka deklaruar se:

➤ *Me qëllim marrjen e një dokumentacioni provues për mundësitë e huadhënësit B.Z, në shumën 10.000 euro, deklaroi se për arsye objektive nuk kam arritur të komunikoj me B.Z. Gjithsesi do të kontaktoj dhe do të marr të dhënat që kërkohen nga ana Juaj, por vërtetoj me dokumentacionin që kam dorëzuar se ky shtetas ka qënë në vitin 2008 ortak dhe administrator i shoqërisë “***” sh.p.k dhe për pasojë ka dorëzuar në vitet para 2008 dhe pas bilance në zyrat tatimore, të cilave do tu drejtohem për të vërtetuar nëse ka pasur burime të ligjshme ky shtetas për të dhënë hua por kam bindjen se provat e garantojnë dhe vërtetojnë këtë mundësi financiare të huadhënësit.*

➤ *Është i vërtetë fakti që nuk është mundur të paguhet huaja deri në vitin 2018 dhe kjo jo pa arsye. Siç rezultoi në vitin 2017 unë jam komanduar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës Parë Përmet në atë Fier dhe ky fakt ma ka bërë të pamundur që unë të arrij, të siguroj të ardhura në masën që kërkonte shlyerja e borxhit, pasi nuk kisha mundësi. Çdo e ardhur shtesë që kam kursyer është përdorur për të bërë të jetueshme banesën në Fier dhe në këto kushte kam kërkuar shtyrje afati huadhënësit nëpërmjet administratorit që përdor dhe administron pallatin ku jetoj dhe pas shumë kërkesash është miratuar kërkesa ime për shtyrje, e provuar kjo me deklaratën noteriale të vitit 2019¹⁰ që kjo hua të shtyhet pasi jam në pamundësi pagese të kësaj shume duke u mirëkuptuar nga huadhënësi¹¹.*

1.27 Qendra Kombëtare e Biznesit¹² konfirmon se B.Z, është ortak zotërues i 100% të kuotave të kapitalit në shoqërinë “***” sh.p.k., regjistruar me NIPT: ***; B.Z është zotërues i 100% të kuotave të kapitalit në shoqërinë “***” sh.p.k., regjistruar me NIPT: ***.

1.28 DRT Berat, me shkresën nr. *** prot., datë 12.9.2017 informoi se B.Z i regjistruar me NIPT ***, ka pasur qarkullim, fitim dhe ka shpërndarë dividend dhe se subjekti nuk ka detyrime tatimore të pashlyera ndaj administratës tatimore.

⁹ Bashkëlidhur dok të ILDKPKI-së gjendet urdhër-xhirim në Credins Bank, për transferimin e shumës 10.000 euro në dt. 8.6.2016, nga B.Z për A.B.

¹⁰ Shih bashkëlidhur dok të përgjigjes së pyetsorit nr. ***: Deklaratë noteriale nr. *** rep., e nr. *** kol., datë 2.8.2019

¹¹ Bashkëlidhur subjekti sjell urdhër xhirimi me nr. *** datë 08.06.2016 të kalimit të shumës prej 10.000 euro, marrë borxh nga B. Z, në llogari të noteres L.Sh, me përshkrimin përkatës, si dhe deklaratën noteriale me nr. *** rep, datë 02.08.2019, të shtyrjes së afatit të shlyerjes së huasë, me palë subjektin dhe B. Z.

¹² Shiko praktikën përkatëse në dosjen e ILDKPKI.

1.29 ISSH, me shkresën nr. *** prot, dt. 28.7.2017, informon se, nga të dhënat që disponojmë (nga viti 2012 e në vazhdim), shtetasi B.Z, ka përfituar të ardhura nga paga pranë shoqërisë “****”.

1.30 Bazuar në pasqyrat financiare të shoqërisë “****”, të cilat janë të depozituara nga vetë shoqëria pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit rezulton:

Viti	Divident i shpërndarë sipas pasqyrave financiare
2007	1,200,000
2008	2,000,000
2009	2,000,000
2010	5,000,000
2011	5,621,750
2014	1,300,350
2015	766,882
TOTAL	17,888,982
Të ardhura pas tatimit¹³	16,061,740

1.31 Analiza financiare e mundësisë së huadhënies nga shtetasi B.Z është bërë nga Komisioni referuar vlerave të dividendëve të shpërndarë nga shoqëria “****” sh.p.k. Nga ky informacion i marrë nga QKB u hartua analiza financiare lidhur me mundësitë e huadhënësit B.Z, për dhënien hua të shumë prej 10,000 euro në vitin 2016.

Analiza e mundësisë së huadhënies 10,000€ nga B.Z

Përshkrimi	Vlera ne Lekë
Te ardhura nga dividenti 2007 - 2015	16,061,740
Shpenzime jetese 2007 - 2015	1,407,946
Dhënë subjektit - 10,000€ - 08.06.2016	1,352,700
Mundësia financiare	13,301,094

1.32 Nga analiza financiare, rezultoi se, shtetasi B.Z kishte mundësi për dhënien hua në vlerën prej 10,000 euro, subjektit të rivlerësimit në vitin 2016 dhe mbulimin e shpenzimeve të jetesës.

1.33 Komisioni ka administruar kthim përgjigjet të Prokurorive pranë Gjykatës së Shkallës Parë Vlorë, Gjirokastrë, Fier dhe Përmet, ku rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur në hetim çështje penale me personin fizik B.Z dhe personin Juridik “****” sh.p.k¹⁴.

1.34 Komisioni hetoi edhe lidhur me çmimin e blerjes së kësaj pasurie në raport me çmimet e përcaktuara për ndërtimet në qytetin e Fierit duke u bazuar në Udhëzimin e KM nr. 4 datë

¹³ Zbritur tatimi mbi të ardhurat nga dividenti sipas ligjit në fuqi

¹⁴ Shkresa nr. *** prot, datë 02.12.2022 e Prokurorisë Vlorë, shkresa nr. *** prot, datë 05.12.2022 e Prokurorisë Gjirokastrë, shkresa nr.*** prot, datë 02.12.2022 e Prokurorisë Fier dhe shkresa,- Informacion dhe vertetim nr. *** prot, datë 05.12.2022 e Prokurorisë pranë Gjykatës Shkallës Parë Përmet.

30.9.2015, nga ku rezultoi se, vlera e tregut të lirë të apartamenteve në qytetin e Fierit është në vlerën 53.030 lekë/m². Sipërfaqja e ndërtimit të blerë nga subjekti i rivlerësimit është 87 m² +11 m² sip të përbashkëta dhe kostoja llogaritet në vlerën (87+11) x 53,030 lekë/m² prej 5,196,000 lekë. Subjekti e ka blerë këtë pasuri në vlerën 45,000 euro (afërsisht 6,087,150 lekë), pra, me një çmim më të lartë se, mesatarja e çmimeve të tregut për periudhën.

1.35 Kësti i katërt në vlerën 4,140,000 lekë, kaluar më datë 20.6.2016, me burim kredi bankare në Raiffeisen Bank.

1.36 Në Dpv-në e vitit 2016, subjekti deklaron si burim të blerjes së apartamentit 4,160,000 lekë, marrë kredi bankare në Raiffeisen Bank me kontratën nr.*** rep., datë 10.06.2016 në Raiffeisen Bank.

1.37 Në deklaratën veting, subjekti ka deklaruar se, ka përfituar kredi për shtëpi sipas kontratës nr. ***, datë 15.6.2016 në Raiffeisen Bank, me afat 20 vjet, për shumën 4,160,000 lekë ose 30,000 euro, me pagesë këste mujore prej 25.208 lekë në muaj.

1.38 Ka rezultuar se, më datë 14.6.2016 është disbursuar kredia në vlerën 4,160,000 lekë në llogarinë e subjektit. Më datë 20.6.2016 është bërë kalimi i vlerës prej 4,140,000 lekë nga llogaria e A. B tek RFZ Bank në favor të noteres L.Sh. me përshkrim “*Kalim me kurs preferencial për kontratën përfundimtare të kredisë*”.

1.39 Në këtë datë (20.6.2016) duket se ka përfunduar likuidimi i vlerës së plotë të blerjes së apartamentit, sipas kontratës së shitblerjes datë 23.5.2016.

1.40 Nga ana tjetër, Raiffeisen Bank, ka vënë në dispozicion dokumentin, - *Kërkesë për transfertë fondesh vetëm brenda banke*, me datë 18.6.2016, me urdhërues Asllan Barjamaj nga llogaria me nr. *** dhe përfitues L.Sh. (Noterja) për shumën 35,000 euro.

1.41 Referuar lëvizjeve bankare të llogarisë në monedhën lekë të subjektit me nr. 0100566111, rezulton se kjo transfertë nuk është realizuar.

1.42 Gjithashtu, referuar të gjitha pagesave të kryera nga subjekti dhe b/shortja e tij në favor të noteres, duket se nuk përputhet vlera totale e këtyre pagesave dhe as momenti kohor i tyre (datat e transaksioneve) me vlerën dhe kohën e kësaj kërkesë për transfertë. Konkretisht, pagesat për likuidimin e apartamentit, rezultojnë të kryera në datat: 23.5.2016; 6.6.2016; 8.6.2016 dhe 20.6.2016. Ndërsa, kërkesa për transfertë, e cituar në pikën 1.40, mban datën 18.6.2016. Ndërkohë, vlera e pagesave të vërtetuara si të kryera, arrin një total prej 45,000 euro (1,000+4,000¹⁵+10,000+30,000¹⁶) euro, ndryshe nga vlera prej 35,000 euro e shënuar në kërkesën për tranfertë, të cituar më lart.

1.43 Në përfundim të hetimit, Komisioni doli në konstatimet si vijon:

- Subjekti dhe b/shortja e tij kishin pamjaftueshmëri burimesh të ligjshme për depozitimin e shumës 1,000 euro, si pagesë e këstit të parë për blerjen e apartamentit, në datë 23.05.2016 në vlerën - 36,043 lekë.
- Nuk u provua kalimi i shumës prej 35,000 euro, si pjesë e këstit të fundit për blerjen e apartamentit nga subjekti tek pala shitëse, referuar lëvizjeve të llogarisë sipas dokumentit *Kërkesë për transfertë fondesh*.

¹⁵ E barasvlefshme me 554,000 lekë

¹⁶ E barasvlefshme me 4,160,000 lekë

- Ka mospërputhje në lidhje me vlerën dhe kohën e dokumentuar të kryerjes së pagesave për blerjen e apartamentit dhe përmbajtjen e dokumentit të RFZ Bank, - *Kërkesë për transfertë fondesh vetëm brenda banke*, me datë 18.6.2016, për shumën 35,000 euro.

1.44 Për konstatimet e bëra nga Komisioni për këtë pasuri, subjektit iu kërkua të japë shpjegime dhe të paraqesë dokumentacion provues, sipas nenit 52 të ligjit nr.84/2016.

Qëndrimi i Subjektit të Riverësimit:

Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti shpjegoi se nuk kundërshtonte vlerësimin e ekspertit në gjetjen e vlerës minus 36,043 leke, për datën 23.05.2016, kur është paguar kësti i parë i kredisë hipotekore. Kjo shume vijoj subjekti është poseduar nga unë, bashkëshortja dhe femijët.

Ndërsa në lidhje me mosprovueshmërinë e kalimit të shumës prej 35,000 euro, në datë 18.06.2016 tek noteria, sipas dokumentit “Kërkesë për transferim fondesh” subjekti shpjegoi se, nga ana e tij dhe bashkëshortes, fillimisht është aplikuar për shumën prej 35,000 euro, por pas aplikimit vijon ai, jemi njoftuar se kjo shumë nuk kreditohej nga banka dhe është vendosur që kredia të merret në lekë dhe të jetë e barazvlefshme në shumën prej 30,000 euro, sipas kursit të këmbimit valutor të kohës. Në datë 06.02.2023 subjekti i është drejtuar Raiffeisen Bank, e cila është përgjigjur¹⁷, duke pohuar se, ky urdhër transfertë nuk është ekzekutuar nga ana e Bankës, pasi është përpiluar gabim, duke ju referuar shumës prej 35,000 euro, që përkon me shumën e kredisë që është aplikuar fillimisht në bankë. Sikurse rezulton edhe nga të dhënat e nxjerrjes së llogarisë, transferta e saktë që u ekzekutua nga ana e bankës, në favor të L.Sh PF, është transferta datës 20.06.2016 në shumën 4,140,000 lekë, me përshkrimin “Kalim me kurs preferencial për kontratën përfundimtare të kredisë”.

Vlerësimi i Komisionit:

1.45 Lidhur me pamundësinë e depozitimit të vlerës prej 1,000 euro në llogarinë e noteres për blerjen e apartamentit në datën 23.05.2016, në vlerën -36,043 lekë, subjekti nuk provoi të kundërtën për këtë pamundësi financiare, por Komisioni në përfundim nuk e kategorizoi si problematikë këtë pamundësi, duke vlerësuar se ky fakt nuk ndikon në vlerësimin përfundimtar të kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit.

1.46 Ndërsa, në lidhje me dokumentin “kërkesë për transfertë”, të datës 18.06.2016, në vlerën 35,000 euro, pranë RFZ Bank, subjekti arriti të provojë me dokumentacion bankar, se kjo kërkesë për transfertë nuk është realizuar kurrë por është një dokument i plotësuar gabim nga punonjësja e bankës lidhur me shumën që do të transferohej. Realisht shuma e transferuar në ato ditë ka qënë 4,140,000 lekë e barazvlefshme me 30,000 euro, që buron nga kredia e marrë nga subjekti pranë kësaj banke dhe jo 35,000 euro, siç shkruhet në kërkesën e datës 18.6.02023. Si përfundim, shpjegimi i subjektit të rivlerësimit, së bashku me dokumentacionin e sjellë nga ana e tij, u konsiderua i mjaftueshëm dhe shterues.

¹⁷ Shih përgjigjen e Raiffeisen Bank, Zyra Rajonale Fier, Dega *** me nr. *** prot., datë 8.2.2023.

2. Llogari bankare në emër të bashkëshortes tek Tirana Bank.

2.1 Në deklaratën veting, subjekti ka deklaruar 20.000 lekë, në llogari të bashkëshortes në Tirana Bank.

2.2 Nëpërmjet shkresës nr. *** prot, dt. 26.7.2017, Tirana Bank, informon se E.B në dt. 27.1.2017, ka pasur llogari rrjedhëse me gjendje 18.800 lekë.

2.3 Sipas statement bankar nga përgjigja e Tirana Bank me shkresën nr. *** prot., datë 28.6.2022 konfirmohet e njëjta gjendje llogarie në emër të b/shortes së subjektit.

2.4 Në përfundim të hetimit, Komisionit nuk i rezultuan problematika për këtë llogari bankare.

3. Llogari page e subjektit pranë Raiffeisen Bank.

3.1 Në deklaratën veting, subjekti ka deklaruar 135,000 lekë në llogarinë personale të pagës në Raiffeisen Bank. Overdraft në vlerën 135,000 lekë.

3.2 Bazuar në dokumentin “Nxjerrje llogarie” nga Raiffeisen Bank, konfirmohet se subjekti Asllan Barjamaj, ka gjendje në dt. 23.1.2017 vlerën -144,286 lekë¹⁸. Gjithashtu dhe me shkresën nr. *** prot, dt. 27.7.2017, kjo bankë informon se, Asllan Barjamaj në dt. 27.1.2017, ka pasur llogari page me gjendje -144,286 lekë (ovd me limit 280,000 lekë).

3.3 Sipas statement bankar nga përgjigja e RFZ Bank me shkresën nr. *** prot., datë 1.7.2022 konfirmohet e njëjta gjendje llogarie në emër të b/shortes së subjektit.

3.4 Në përfundim të hetimit, Komisionit nuk i rezultuan problematika për këtë llogari bankare.

4. Banesë në përdorim në lagjen *, Përmet.**

4.1 Në deklaratën vetting, subjekti ka deklaruar se, ka përdorur banesën në Lagjen “***”, Përmet- të marrë me qira së bashku me familjen në të cilën qëndrojmë dhe jetojmë prej muajit Nëntor 2011. Qira mujore paguhet çdo fillim muaji 12.000 lekë në muaj.

4.2 Komisioni bëri pjesë të analizës financiare, vlerat e qirave dhe shpenzimet e udhëtimit, duke u mbështetur në deklarinimin e subjektit të rivlerësimit. Lidhur me mundësitë për pagesat e qirave shiko analizën financiare për vitet 2011-2016.

4.3 Është konstatuar se, ndër vite ka deklaruar si adresë banimi edhe qytetin e Vlorës dhe Gjirokastrës, për të cilat subjekti në deklaratën vetting nuk ka deklaruar nëse kanë qenë pasuri në përdorim nga ana e subjektit.

4.4 Në përgjigje të pyetsorit standart, subjekti ka deklaruar dhe adresat e banimit ndër vite dhe marrëdhëniet me qeradhënësit. Subjekti deklaruar se ka filluar punë në muajin Nëntor 2007 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë. Nga muaji Nëntor 2007 deri në Shtator 2008 ka jetuar në shtëpinë e prindërve të tij në Patos, Fier. Nga muaji Shkurt 2008 deri në muajin Nëntor 2008 ka qëndruar në një banesë të marrë me qera në qytetin e Vlorës, në administrim të shtetasit Sh.B, me qera mujore 15,000 lekë në muaj. Nga muaji Dhjetor 2008 - Nëntor 2011 ka jetuar në Gjirokastër, në tre banesa të ndryshme (Dhjetor 2009-Qershor 2009 në banesën e R.B, paguar 15,000 lekë në muaj; Korrik 2009-Dhjetor 2009 në banesën e shtetasit

¹⁸ Shih edhe dokumentin,-Nxjerrje llogarie, për periudhën 2005 – 2017.

A.R, paguar 18,000 lekë në muaj dhe Janar 2010 – Nëntor 2011, banuar në banesën e V.B, paguar 14,000 lekë në muaj). Në muajin Nëntor 2011-Shtator 2017 ka jetuar në një banesë të shtetasit G.K, me pagesë vitin e parë 10,000 lekë në muaj dhe më pas 12,000 lekë në muaj. Nga muaji Shtator 2017–Nëntor 2019 ka jetuar në banesën e tij në qytetin e Fierit (pasi ka qënë i komanduar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier). Nga muaji Nëntor 2019 e në vijim, subjekti deklaroi se jeton vetëm, në Përmet (familja e tij jeton në Fier), tek banesa e A.K, me qera mujore 8,000 lekë në muaj.

Subjekti ka deklaruar se nuk ka bërë kontrata formale qiraje me pronarët e këtyre banesave.

4.5 Në përgjigje të pyetsorit nr. ***, subjekti ka deklaruar dhe shpenzimet e udhëtimit nga adresa e banimit drejt vendit të punës dhe anasjelltas për gjithë kohën e deklarimit¹⁹, shpenzime të cilat janë bërë pjesë e analizës financiare.

4.6 Konkluzione të Komisionit:

➤ Në përfundim të hetimit, Komisioni konstatoi se, subjekti nuk ka provuar me dokumenta ligjor qëndrimin e tij me qira në pasuritë e deklaruar në përgjigje të pyetsorit standard dhe as ka dokumentuar shpenzimet e qirave përgjatë viteve në këto banesa.

Për konstatimin e bërë nga Komisioni për këto marrëdhënie me qeradhënësit e banesave, Komisioni i kërkoi subjektit të provojë me dokumentacion provues (vërtetim nga prokuroria) mospasjen e konfliktit të interesit duke vërtetuar se nuk ka pasur në ndjekje dhe shqyrtim ndonjë çështje me qeradhënësit, ku subjekti ka jetuar dhe jeton edhe tani me qera në qytetin e Përmetit.

Qëndrimi i Subjektit të Riverësimit:

4.7 Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti shpjegoi se, *që nga viti 2008 deri në vitin 2019 nuk kishte lidhur kontrata formale, me personat që i kishin dhënë banesat me qira.*

Për të provuar se nuk ka pasur çështje penale me personat në banesat e te cileve ka jetuar me qira, subjekti paraqiti vërtetimet²⁰ e lëshuara nga Prokuroria Pranë Gjykatës Shkallës Parë Vlorë, Gjirokastër dhe Përmet.

4.8 Gjithashtu, subjekti ka sjellë kopje deklaratash noteriale të shtetasve G.K, V.B, A.R, ku vërtetohen kryerja e pagesave të qerave për periudhat e jetesës në këto banesa.

Vlerësimi i Komisionit:

4.9 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, me anë të vërtetimeve të Prokurorive Përmet, Gjirokastër dhe Vlorë, u provua se, prokurori A.B nuk ka pasur në proces hetimi/gjykimi çështje me të pandehur, të dyshuar, viktime ose të dëmtuar shtetasit e listuar sipas kërkesës së bërë nga Komisioni.

4.10 Ndërsa në lidhje me qëndrimin me qira të subjektit në adresa të ndryshme të deklaruar nga ana e tij, Komisioni, kishte bërë pjesë të analizës financiare vlerat e qirave, referuar deklarimit të subjektit të rivlerësimit, por edhe referuar dokumentacionit të sjellë në përgjigje të rezultateve të hetimit, konfirmohen të njëjtat vlera qiraje të shpenzuara ndër vite.

¹⁹ Shih përgjigjen e pyetsorit nr. ***, përgjigje e pyetjes nr.***.

²⁰ Shih vërtetimet e lëshuara nga Prokuroritë përkatësisht me nr.*** prot., datë 10.2.2023 Përmet; nr. *** prot., datë 10.2.2023 Gjirokastër dhe nr. *** prot., datë 9.2.2023 Vlorë.

Detyrime financiare.

5. Kredi për shtëpi në vlerën 4,160,000 lekë në RFZ Bank.

5.1 Në deklaratën vetting, subjekti ka deklaruar se ka aplikuar në Raiffeisen Bank për kredi në shumën 35.000 euro për blerje banese, por është miratuar shuma 4.160.000 lekë ose 30.000 euro.

5.2 Bazuar në Kontratën e kredisë bankare me nr. *** rep, nr. *** kol, dt. 10.6.2016, rezultoi se subjekti dhe bashkëshortja kanë përfituar kredi pranë RFZ, në shumën 4.160.000 lekë për blerje shtëpie. Kredia është marrë me afat 20 vjet, me pagesë këste mujore prej 25.208 lekë në muaj.

5.3 Raiffeisen Bank me shkresën nr. *** prot, dt. 21.7.2017 konfirmon se, Asllan Barjamaj në dt. 27.1.2017, ka pasur llogari kredie me gjendje - 4.079.806 lekë.

5.4 Gjithashtu, Raiffeisen Bank me shkresën me nr. *** prot., datë 1.7.2022 vërteton kredi me gjendje detyrimi 4,091,377 në datën 31.12.2016.

5.5 Çështjet lidhur me këtë kredi janë trajtuar në pikën 1 të këtij vendimi pasi kjo kredi është përdorur për blerjen e pasurisë apartament dhe për të cilën nuk kanë rezultuar problematika.

6. Kredi konsumatore në RFZ Bank.

6.1 Në deklaratën Vetting, subjekti ka deklaruar përfitim të një kredie konsumatore në Raiffeisen Bank, në shumën 500,000 lekë. Rinovuar kjo kredi me kontratën nr. *** datë 19.1.2015, në shumën 700,000 lekë deri në vitin 2020. Mbetur për tu shlyer në Raiffeisen Bank shuma 494,002 lekë.

6.2 Raiffeisen Bank konfirmon me vërtetimin me nr.*** prot., datë 23.1.2017 kredi me gjendje detyrimi 494,002 lekë. Gjithashtu kjo bankë me shkresën nr. *** prot, dt. 21.7.2017, informon se Asllan Barjamaj në dt. 27.1.2017, ka pasur llogari kredie me gjendje -482.971 lekë.

6.3 Raiffeisen Bank me shkresën me nr. *** prot., datë 1.7.2022 vërteton kredi me gjendje detyrimi 494,002 lekë në datën 31.12.2016.

6.4 Në përfundim të hetimit, Komisionit nuk i rezultuan problematika për këtë kredi bankare.

7. Kredi tek shoqëria e kreditit “NOA” në shumën 350,000 lekë.

7.1 Në deklaratën vetting, subjekti ka deklaruar se ka marrë kredi në vitin 2011 në shoqërinë e kreditit “NOA”, në shumën 350.000 lekë, shlyer në Qershor 2014 plotësisht.

7.2 Bazuar në kontratën e huasë dt. 21.6.2011, me huamarrës Asllan Barjamaj dhe E.B dhe huadhënës shoqëria “NOA” sh.a, rezultoi kredia e marrë në shumën prej 350.000 lekë.

7.3 Bazuar në shkresën me nr. *** prot., datë 30.6.2022, institucioni financiar Noa vërteton se kontrata e huasë së vitit 2011 rezultoi e likuaduar në vitin 2014.

7.4 Në analizën financiare janë përfshirë shpenzimet e kësteve të kredisë që rezultojnë nga ky institucion financiar.

7.5 Në përfundim të hetimit, Komisionit nuk i rezultuan problematika për këtë kredi bankare.

8. Kredi me kufi (overdraft) tek RFZ Bank.

8.1 Subjekti ka deklaruar kredi me kufi (Overdraft) tek Raiffeisen Bank çelur në vitin 2006, ndryshuar disa herë dhe ka ndryshuar në datë 4.8.2014, bërë tre paga mujore. Në datën 26.8.2016, është ndryshuar duke u marrë 60.000 lekë me afat 30 vjet dhe shuma totale është 280.000 lekë.

8.2 Bazuar në dokumentin “nxjerrje llogarie” nga Raiffeisen Bank, konfirmohet llogari page në emër të subjektit (trajtuar më sipër në pikën 3 të këtij relacioni), me gjendje në dt. 23.1.2017²¹, në vlerën -144.286 lekë (ovd me limit 280.000 lekë).

8.3 Në përfundim të hetimit, Komisionit nuk i rezultuan problematika për këtë kredi (overdraft).

9. Huadhënie në vlerën 300,000 lekë, kunatit F. S.

9.1 Në deklaratën veting, në rubrikën, “*të dhëna konfidenciale*”, subjekti ka deklaruar se i ka dhënë hua kunatit F.S, në vitin 2009, shumën 300.000 lekë (ende pa kthyer), për banesën e re ndërtuar prej tij dhe motrës së tij, M.S (B), në fshat ku jetojnë aktualisht.

9.2 Rezulton se, kjo huadhënie është deklaruar nga subjekti në Dpv-në e vitit 2010 dhe jo në DPV-në e vitit 2009.

9.3 Në analizën financiare, kjo huadhënie është përfshirë në vitin 2010, sipas deklaramit të bërë nga subjekti në DPV-në e atij viti.

9.4 Komisioni pyeti subjektin në lidhje me mundësitë e kësaj huadhënieje. Në përgjigje të pyetsorit nr.***, subjekti deklaroi se burimi i të ardhurave për të përballuar shpenzimet familjare janë te ardhurat e tij dhe bashkëshortes, si dhe nga kreditë e marra në vitet 2009 dhe në vitin 2010.

9.5 Referuar rezultatit pozitiv të vitit 2010²², duket se subjekti dhe bashkëshortja e tij kishin të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të dhënë këtë hua dhe për të mbuluar shpenzimet e periudhës.

9.6 Në përfundim të hetimit Komisioni konkludoi se, subjekti nuk e ka provuar me dokumentacion dhënien e kësaj huaje, si dhe ka bërë deklaramit të pasaktë lidhur me vitin e dhënies së kësaj huaje.

9.7 Për konstatimin e mësipërm të bërë nga Komisioni për këtë pasuri subjektit iu kërkua të japë shpjegime dhe të paraqesë dokumentacion provues.

Qëndrimi i Subjektit të Riverësimit:

9.8 Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti shpjegoi se, ky konstatim i Komisionit është i saktë dhe për këtë ka sjellë deklaratë noteriale nga kunati i tij, F.S, datë 06.02.2023, i cili ka përcaktuar qëllimin e marrjes së kësaj huaje dhe kohën (rikonstruksion shtëpisë, Nëntor 2009), kohë kur është marrë edhe kredia në Raiffeisen Bank dhe me një pjesë është blerë automjeti dhe pjesa tjetër (kursimet që kishte), i ka dhënë hua kunatit për të bërë punimet në banesën e tij, në fshat. Kjo pasaktësi është shkaktuar për shkak se ai nuk e ka deklaruar periudhën e saktë të dhënies së kësaj huaje (Nëntor 2009).

²¹ Si dhe nxjerrje llogarie për periudhën 2005 – 2017.

²² Shiko analizën financiare për vitin 2010.

Vlerësimi i Komisionit:

9.9 Për huanë e dhënë shtetasit F. S (kumatit të subjektit), u provua se subjekti e ka dhënë këtë hua në Nëntor të vitit 2009²³ dhe se, kjo shumë buron nga kredia e marrë në këtë vit pranë Raiffeisen Bank.

9.10 Në të njëjtat prapësime, subjekti deklaroi se kredia e marrë tek Raiffeisen Bank në vitin 2009 (500,000 lekë) ka shërbyer për pagesën e vlerës 2,500 euro (= 345,025 lekë) shtetasit G.H. për blerjen e një automjeti dhe me pjesën e mbetur bashkë me kursimet e tjera në shtëpi, i është dhënë huaja kumatit për shtëpi.

9.11 Komisioni, pas shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit vlerësoi se, pavarësisht deklarimit të tij në shpjegimet përfundimtare, vlera e huasë duhet përfshirë në analizën financiare të vitit 2010, sipas deklarimit periodik të bërë nga subjekti.

ÇËSHTJE TË TJERA:

10. Automjete në përdorim.

10.1 Në deklaratën veting subjekti ka deklaruar se ka pasur në posedim dy automjete dhe konkretisht:

- *Automjetin *** blerë në vitin 2008 dhe shitur në vitin 2009 me dokumente të shtetit Italian.*
- *Automjetin *** blerë në Tetor të vitit 2009 pa dokumente të rregullta në shumën 2.500 euro dhe është shitur në vitin 2014 tek P. D, Përmet për 80.000 lekë pa kontratë noteriale por me një deklaram të thjeshtë.*

10.2 Në lidhje me automjetin * blerë në vitin 2008.**

- Në përgjigje të pyetsorit standart, subjekti ka deklaruar se për blerjen e automjetit me targë BG ***, në vitin 2008, (me kontratë huapërdorje), babai e ka ndihmuar me shumën prej afro 200,000 lekë dhe se ky automjet është përdorur deri në muajin shtator 2009 me të njëjtat targa dhe dokumentacion italian. Më pas është deklaruar i shitur tek shtetasi E. K në shumën 80,000 lekë.
- Në Dpv-në e vitit 2008, subjekti ka deklaruar se ka në posedim një automjet *** pa kontratë shitblerje por thjesht me aktpërdorim. Shuma e dhënë 150,000 lekë.

10.3 Në lidhje me automjetin * blerë në vitin 2009.**

- Në përgjigje të pyetsorit standart, subjekti ka deklaruar se, ka blerë automjetin *** në vlerën 2,500 euro, shtetasit G.H, por për shkak të konfliktit me këtë shtetas në lidhje me kushtet në të cilat ndodhej automjeti dhe dokumentacioni i tij, nuk është bërë e mundur as marrja e dokumentacionit origjinal të automjetit dhe as kthimi i shumës mbrapsht.
- Në Dpv-në e vitit 2009 subjekti deklaroi blerjen e një automjeti ***, blerë në 2009 nga lekët e marra kredi në muajin tetor 2,500 euro.
- Në Dpv-në e vitit 2014 subjekti ka deklaruar shitjen e këtij automjeti në muajin tetor 2014 në vlerën 100,000 lekë.

10.4 Për këto automjete të deklaruara të blera dhe të shitura përgjatë viteve, por edhe për shkak të paqartësive në lidhje me marrëdhëniet me personat shitës të këtyre automjeteve, si dhe për shkak të mungesës së dokumentacionit të duhur ligjor të këtyre transaksioneve është pyetur subjekti²⁴.

²³ Shih deklaratën noteriale të F.S (kumatit të subjektit).

²⁴ Shih pyetsorin nr. ***drejtuar subjektit të rivlerësimit.

10.5 Në përgjigje të pyetsorit nr. *** subjekti ka deklaruar se:

- *Automjeti me targa BG***, *** është marrë prej meje nga F. A në muajin Gusht 2008 me kontratë përdorimi, kundrejt vlerës 150,000 lekë, por në banesë gjeta vetëm kopje të vërtetimit të hyrjes së automjetit, me nr. serial *** datë 26.07.2008 (duke qënë se origjinalin ia kam dhënë E. K). Më ka ndihmuar babai im, por duke qënë një marrëdhënie brenda familjes nuk kam deklaruar pasi nuk ka qënë as hua dhe as dhuratë, pasi prindërit nuk kanë mundësi të bëjnë dhurata dhe kërkoj ndjesë për mos deklarimin. Kam kërkuar nga viti 2020 dhe aktualisht, një takim me shtetasin E.K, por ky shtetas nuk bashkëpunon dhe nuk vë në dispozicion asnjë dokument të automjetit. Burimi i të ardhurave të siguruara nga babai im është fondi nga asistenca e përfutur në vitin 2008, në shumën prej 200.000 lekë dhe këtë fakt e them me bindje plotë.*

- *Automjetin *** e kam marrë nga G. H, me të cilin kemi qënë në të njëjtin vit studimor në Shkollën e Magjistraturës dhe ai dhe unë kemi ushtruar përkatësisht detyrën e Prokurorit dhe Gjyqtarit në Gjykatën Shkallës Parë Vlorë. Këtë automjet e kam marrë në përdorim për shumën e 2500 eurove, pa doganë të paguar, dhe me premtimin se, dokumentacioni i automjetit do të më vihej në dispozicion më vonë pasi të bëja pagesën. Kam marrë automjetin dhe kam aplikuar për kredi në Raiffiesen Bank, në vitin 2009 dhe po atë ditë që është disbursuar kredia, kam derdhur shumën e konvertuar në bankë, në emër të G.H. Ja kam kërkuar disa herë dokumentacionin e automjetit dhe targat por pasi nxirrte justifikime, kam ndërprerë çdo komunikim pasi nuk dha asnjë zgjidhje për këtë problem. Në Tetor të vitit 2014 këtë automjet e kam shitur për skrap në pikën e grumbullimit të shtetasit P. D dhe këtë dokument e kam dorezuar në ILDKPI në vitin 2017 dhe nuk kam dokument tjetër.*

10.6 Komisioni administroi shkresat kthim përgjigjet²⁵ sipas kërkesave të bëra, Prokurorive pranë Gjykatës së Shkallës Parë Vlorë, Gjirokastër, Fier dhe Përmet, ku rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur në hetim çështje penale me shtetasit e përmendur më sipër.

10.7 Komisioni bëri pjesë të analizës financiare vlerat e deklaruara si të shpenzuara për përdorimin/blerjen e këtyre automjeteve përkatësisht: 150,000 lekë të automjetit tip *** në vitin 2008 dhe 2,500 euro të automjetit tip *** në vitin 2009.

10.8 Në lidhje me burimin e 200,000 lekëve, shumë e deklaruar si e dhënë nga babai i subjektit për blerjen e automjetit tip *** në vitin 2008, subjekti ka paraqitur një statement bankar²⁶ të llogarisë së babait Xh.B tek Tirana Bank ku rezulton se, më datë 14.7.2008 ka një hyrje në llogari në shumën 515,597 lekë me përshkrim, “*Paguar shpërblim për vjetërsi pune ****, *Patos*”. Kjo shumë tërhiqet e gjitha deri më 18.8.2008, çka duket se, babai i subjektit ka pasur mundësi financiare t’ia japë subjektit këtë shumë prej 200,000 lekë.

10.9 Për shkak të faktit se, subjekti nuk e ka deklaruar si burim të blerjes së automjetit dhe as si dhurim në rubrikën e posaçme në DPV e vitit 2008, Komisioni nuk e përfshiu këtë vlerë në analizën financiare.

10.10 Ndërsa për vlerat e deklaruara si të përfuturara nga dhënie/shitja përkatësisht 80,000 lekë nga automjeti tip *** në vitin 2009 dhe 100,000 lekë nga automjeti tip *** në vitin 2014, Komisioni nuk i bëri pjesë të analizës financiare, për shkak të mosdokumentimit të realizimit të këtyre të ardhurave.

²⁵ Shkresa nr. *** prot, datë 02.12.2022 e Prokurorisë Vlorë, shkresa nr. *** prot, datë 05.12.2022 e Prokurorisë Gjirokastër, shkresa nr.*** prot, datë 02.12.2022 e Prokurorisë Fier dhe shkresa,- Informacion dhe vertetim nr. *** prot, datë 05.12.2022 e Prokurorisë pranë Gjykatës Shkallës Parë Përmet.

²⁶ Shih përgjigjen e pyetsorit standart.

10.11 Në përfundim të hetimit për këto dy automjete, Komisioni arriti në konkluzionet si vijon dhe për të cilat i kaloi barrën e provës në përputhje me nenin 52 të ligjit 84/2016:

- Automjetet nuk rezultuan të regjistruara në emër të subjektit.
- Subjekti nuk ka deklaruar dhurim apo hua nga babai në shumën prej 200,000 lekë në vitin 2008.
- Subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor dhe nuk ka provuar blerjen e automjetit *** në vlerën prej 200,000 lekë dhe shitjen me pas në vlerën prej 80,000 lekëve dhe nuk ka shpjeguar mospërputhjen midis Dpv-së së vitit 2008 dhe përgjigjes së pyetsorit lidhur me vlerën e blerjes së këtij automjeti.
- Subjekti nuk ka provuar me dokumentacion përdorimin/blerjen dhe as shitjen e automjeteve.

Qëndrimi i Subjektit të Riverësimit:

10.12 Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti parashtroi se, nuk ka rregjistruar në emrin e tij automjetin tip ***, me targa BG ***, por nga kontakti me shtetasit M.H, F. A dhe me E. K ka arritur të vërtetojë se, më datë 25.07.2008 automjeti me targa BG ***, është futur në territorin shqiptar nga M.H., pastaj ai i ka dhënë prokurë të posaçme shtetasit F.A dhe ky i fundit, në datë 11.02.2023, me deklaratë noteriale ka konfirmuar faktin që i ka dhënë këtë automjet subjektit. Ndërsa, E. K. me deklaratën noteriale të datës 8.2.2023 ka deklaruar se, në muajin nëntor 2009 ka blerë automjetin nga A.Barjamaj në vlerën 80,000 lekë pa kontratë shitje, të cilin e ka përdorur deri në vitin 2010 dhe pastaj e çuar për skrap. Sipas subjektit, këto fakte vërtetohen me deklaratat noteriale bërë nga E. K dhe F.A.

10.13 Në deklaratën vjetore 2008 subjekti nuk ka paraqitur burimin e të ardhurave për blerjen e automjetit që i janë dhënë nga babai i tij, por deklaroi se këtë shumë (150,000 lekë) babai i tij ja ka dhënë shitësit F.A., në muajin Gusht 2008. Në përgjigje pyetesori standart ka deklaruar se ka marrë shumën 200,000 lekë nga babai dhe 150.000 lekë i janë dhënë F.A dhe pjesa tjetër është paguar deklarata e përdorimit të mjetit që kushtonte rreth 7,000 lekë dhe janë kryer shërbimet e automjetit.

10.14 Ndërsa në lidhje me transaksionin e kryer për automjetin ***, në vitin 2009, subjekti pranon mungesën e dokumentacionit si një problematikë të theksuar dhe shpjegon se, ka deklaruar në ILDKPI, në vitet 2009, 2010 dhe 2014 se ka në përdorim një automjet, të cilin e ka marrë 2500 euro. Ky dokument përputhet me dokumentin transfertë bankare (që kalon shuma prej 2500 euro shtetasit G.H), që mban të njëjtën datë, kur është marre kredia në vitin 2009. Si dhe siç rezulton nga lëvizja e llogarisë bankare në Raiffeisen Bank, në datë 26.10.2009 subjekti sqaron se, ka marrë kredi shumën 500,000 lekë dhe po në këtë datë, në NBG Bank, Dega Gjirokastrë, ka bërë derdhjen shumës 2,500 euro në emër të G.H. Subjekti shton se, pavarësisht se, automjeti ka qënë pa dokumenta (sepse nuk i janë dhënë kurrë nga shitësi G.H.), prapëseprapë është i ndërgjegjshëm se mbajtja e automjetit pa dokumenta është një veprim jo etik.

Vlerësimi i Komisionit:

10.15 Komisioni, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, lidhur me automjetin e deklaruar si të blerë pa dokumentacion nga F.A., duke marrë në konsideratë edhe deklaratën noteriale të shitësit të vitit 2023, i cili pohon deklarimin e subjektit për blerjen e këtij automjeti pa dokumenta në vlerën 150,000 lekë në vitin 2008. Gjithashtu mori në konsideratë edhe

deklaratën noteriale të vitit 2023 të shtetasit E. K, ku subjekti pretendoi se e ka shitur këtë automjet në vlerën 80,000 lekë, sërish pa dokumenta.

10.16 Lidhur me mosdeklarimin e dhurimit nga ana e subjektit të shumës prej 200,000 lekë nga babai për blerjen e automjetit, në vitin 2008, subjekti pranoi se nuk e ka deklaruar këtë dhurim, por realisht këto para, i ka dhënë babai i tij shitësit të automjetit (150,000 lekë) dhe pjesën tjetër subjekti e ka përdorur për dokumentacion dhe për disa shërbime të bëra automjetit.

10.17 Pavarësisht, shpjegimeve të subjektit në shpjegimet përfundimtare, mosdeklarimi i këtij dhurimi nga ana e subjektit në DPV-në e vitit 2008 dhe në deklaratën Vetting, është argument për mospërfshirjen e këtij dhurimi si e ardhur e ligjshme për vitin pëkatës.

10.18 Lidhur me automjetin e blerë nga shtetasi G. H. subjekti pretendoi se, marrëdhënia e blerjes së automjetit vërtetohet nga transfertat bankare e vlerës prej 2,500 euro si dhe nga fakti se kredia e marrë tek RFZ (500,000 lekë) është në të njëjtën datë me transfertën e vlerës 2,500 euro (345,025 lekë).

10.19 Ndërsa për mbajtjen e një mjeti të parregjistruar, subjekti deklaroi se, *“ligjërisht, me një autorizim në vitin 2008, mund të mbaje një automjet me targa të huaja deri në 1 vit”*, por nuk bën të njëjtin arsyetim tek rasti i mbajtjes së automjetit ***, të cilin e ka mbajtur për 5 vite (2009-2014).

10.20 Në përfundim, Komisioni në lidhje me këto dy pasuri (automjete), të cilat nuk i kishte në momentin e dorëzimit të deklaratës Vetting, por për të cilat kishte deklaruar në vitet e mëparshme, konsideroi se, subjekti duhej të kishte kryer veprimet në përputhje me ligjin, në kuptimin e kalimit të të drejtave pasurore dhe pagimin e detyrimeve përkatëse. Për më tepër, mbajtja e një automjeti për disa vite (siç është rasti i mjetit *** 2009-2014) pa dokumente nuk përbën veprim të rregullt ligjor për një magjistrat.

10.21 Megjithatë, në vlerësimin përfundimtar, Komisioni nuk vlerësoj qe veprimet apo mosveprimet e subjektit te perbenin shkak per mase disiplinore.

10.22 Ashtu, siç subjekti është njoftuar në rezultatet e hetimit, për shkak të mosdokumentimit të realizimit të të ardhurave të deklaruara nga dhënia/shitja e automjeteve, përkatësisht 80,000 lekë nga automjeti tip *** në vitin 2009 dhe 100,000 lekë nga automjeti tip *** në vitin 2014, Komisioni nuk i bëri ato pjesë të analizës financiare.

10.23 Ndërkohë shpenzimet për blerjen e automjetit tip *** në vitin 2008 në analizën financiare do të jenë në vlerën 200,000 lekë të cilën e pretendon vetë subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit.

11. Kursimet Cash

11.1 Në DPV-në e vitit 2012 subjekti ka deklaruar për herë të parë vlerën cash 150,000 lekë. Në vitet në vazhdim nuk ka deklaruar shtesë apo pakësim të këtyre kursimeve.

11.2 Subjekti për blerjen e pasurisë apartament në vitin 2016, ka listuar si një prej burimeve të blerjes, edhe kursimet e mëparshme të veta dhe të bashkëshortes, por duke mos cilësuar se këtu përfshihen apo jo kursimet cash.

11.3 Për këtë arsye, Komisioni nuk ka përfshirë si burim në blerjen e apartamentit, kursimet cash të vitit të mëparshëm në vlerën 150,000 lekë.

11.4 Në analizën financiare vlera e deklaruar e kursimeve cash prej 150,000 lekë mbetet e pandryshuar nga viti 2012 deri në vitin 2016, mundësi e cila është e detajuar në tabelën e AF.

11.5 Në përfundim të hetimit, Komisionit i rezultoi mospërputhje lidhur me deklarin cash ndër vite nga subjekti, duke mos deklaruar shtesa dhe pakësime të gjendjes Cash, sipas detyrimit që përcakton ligji 9049/2003, i ndryshuar.

Qëndrimi i Subjektit të Rivlerësimit:

11.6 Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti ka shpjeguar se, kjo shumë cash ka ekzistuar vetëm në vitin 2012 dhe jo vitet e tjera dhe ndaj nuk ka shënuar pakësim në deklaratën vjetore 2013.

Vlerësimi i Komisionit:

11.7 Komisioni, pas shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit arriti në përfundimin se, subjekti i rivlerësimit, nuk ka përmbushur detyrimin ligjor, për deklarim të ndryshimit të gjendjes cash, në kuptimin e shtimit ose pakësimit të tij, duke mos bërë asnjë shënim për këto kursime në Dpv-të përkatëse.

11.8 Në analizën financiare, kursimet cash u vlerësuan sipas deklarimeve periodike të kohës, duke lënë vlerën e deklaruar të kursimeve cash prej 150,000 lekë të pandryshuar nga viti 2012 deri në vitin 2016.

12. Automjeti me targa AA * në emër të b/shortes**

12.1 Në DPV e vitit 2015 bashkëshortja e subjektit ka deklaruar pasurinë automjet tip *** blerë në vlerën prej 150,000 lekë. Si burim ka deklaruar të ardhura të kursyera nga rrogat mujore.

12.2 DPSHTRR, me shkresën nr. *** prot, dt. 11.9.2017, konfirmon automjetin me targa AA***, në emër të bashkëshortes së subjektit. Ky automjet rezultoi i blerë me kontratë shit-blerje automjeti nr. *** rep, nr. *** kol, dt. 12.3.2015, me çmimin 150.000 lekë.

12.3 Në DPV-në e vitit 2016 dhe në deklaratën vetting b/shortja e subjektit ka deklaruar të ardhura nga shitja e këtij automjeti në vlerën 130,000 lekë.

12.4 Nga hetimi²⁷, rezultoi një kontratë shit-blerje automjeti me nr. *** rep, nr. *** kol, dt. 12.3.2015, me blerës E.B, me çmimin 150,000 lekë. Gjithashtu me kontratë shitje me nr. *** rep., e nr. *** kol., datë 6.8.2016, është shitur ky automjet në vlerën 130,000 lekë.

12.5 Është analizuar mundësia financiare e subjektit dhe b/shortes për blerjen e këtij automjeti në vitin 2015.

12.6 Në këtë analizë financiare, janë përfshirë edhe të ardhurat nga kredia e marrë me datën 19.1.2015 për arsye se, ato ndikojnë në rritjen e likuiditeteve bankare të përfshira në analizë brenda kësaj periudhe.

Analiza e mundësisë së blerjes së automjetit - 12.03.15

Pershkrimi	Vlera
Te ardhura nga paga subjekti 01.01.15 - 12.03.15	505,838
Te ardhura nga paga b/shortja 01.01.15 - 12.03.15	132,357
Kredi tek Raiffeisen subjekti dt. 19.01.15	700,000
Te ardhura totale 01.01.15 - 12.03.15	1,338,195

²⁷ Shih përgjigjen e DPSHTR me nr. *** prot., datë 4.7.2022, protokolluar në KPK me nr.*** prot., datë 6.7.2022.

Shpenzime jetese 01.01.15- 12.03.15	186,897
Shpenzime kredie 01.01.15- 12.03.15	412,150
Shpenzime qiraje 01.01.15- 12.03.15	36,000
Shpenzime totale 01.01.15- 12.03.15	635,047
Ndryshim likuiditeti 31.12.14 -12.03.15	466,019
Blere automjet b/shortja dt.12.03.15	150,000
Mundësia financiare	87,129

12.7 Nga analiza financiare, rezultoi se, subjekti dhe b/shortja kishin të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e këtij automjeti, shtimin e likuiditeteve dhe mbulimin e shpenzimeve të jetesës.

12.8 Në analizën financiare të vitit 2016, janë përfshirë të ardhurat nga shitja e këtij automjeti.

12.9 Gjithashtu, me shkresën nr. *** prot, dt. 9.8.2017, informohet se E.B, ka në pronësi automjetin me targa AA ***, të regjistruar në DPSHTRR Gjirokastër (por pa dokumentacion).

12.10 Nga hetimi i Komisionit, referuar përgjigjes të DPSHTRR-së me nr. *** prot., datë 4.7.2022, nuk rezultoi asnjë informacion dhe dokumentacion për këtë automjet.

12.11 Në përfundim të hetimit, Komisioni doli në konkluzionin se, subjekti nuk ka deklaruar automjetin në pronësi të bashkëshortes me targa AA*** dhe për këtë konstatim, iu kërkua të japë shpjegime lidhur me mosdeklarimin, vitin e blerjes, burimin e krijimit, si dhe të paraqiste kopje të kontratës të shitblerjes dhe dokumentacionit ligjor për këtë pasuri-automjet.

Qëndrimi i Subjektit të Riverësimit:

12.12 Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti shpjegoi se, ai dhe as bashkëshortja e tij nuk kanë poseduar një automjet me targat e mesipërme dhe kthim përgjigjet e DPSHTRR të vitit 2017 janë të gabuara sepse automjeti me targen AA***, rezulton automjeti i markës ***, në emër të shtetasit R.I.S., me adresë Elbasan²⁸.

Vlerësimi i Komisionit:

12.13 Komisioni, pas shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit arriti në përfundimin se, subjekti i rivlerësimit, provoi me dokumentacion provues se bashkëshortja e tij nuk ka qënë kurrë në ponare e këtij mjeti dhe se automjeti ka qënë gjatë viteve në pronësi të shtetasve të tjerë.

13. Detyrime financiare:

13.1 Në deklaratën vetting b/shortja e subjektit ka deklaruar:

➤ Marrjen e një kredie te IuteCredit për blerje elektroshtëpiake të *** me një vlerë 100.000 lekë, për një afat 1 vit (31.8.2016-31.7.2017) me këst mujor 10,250 lekë. Detyrimi për t'u shlyer 62,000 lekë. Nga statement i Raiffeisen Bank si dhe nga përgjigja e BKT²⁹, rezultojnë pagesa të këtyre kësteve prej 10,250 lekë për kësti kredie në favor të Iute Credit Albania. Në analizën financiare, janë përfshirë pagesat e kësteve të kësaj kredie në vitin 2016.

²⁸ Shih dokumentacionin bashkëlidhur shpjegimeve përfundimtare.

²⁹ Përgjigje nga BKT, nr. *** prot. dt. 4.7.2022

➤ Marrjen e një kredie për blerje laptop, në Raiffeisen Bank Neptun Fier, në vlerën totale 34.900 lekë, dt. 18.8.2015, me afat 24 muaj, interesi 15.21%, kësti 1.841.43 lekë. Detyrimi i mbetur deri 24.1.2014 është 11.929 lekë. Raiffeisen Bank konfirmon marrje kredie në datë 18.8.2015, nga E. B, në shumën në 34.900 lekë, për blerje laptopi, dhe se në dt. 27.1.2017, gjendja e pashlyer e detyrimit ka qënë në vlerën -11.929 lekë.

➤ Marrjen e një kredie më 7.10.2013, “kredi me kufi” në llogari rrjedhëse (overdraft) në shumën 80.000 lekë, në Raiffeisen Bank, Përmet. Detyrimi i mbetur për t’u shlyer deri 24.1.2017 është 44.917 lekë. Kontrata Kufi Kredie (Overdraft), dt. 7.10.2013, është lidhur mes E.B dhe Raiffeisen Bank, për overdraft në vlerën 80.000 lekë.

13.2 Në përfundim të hetimit, Komisionit nuk i rezultuan problematika në lidhje me këto detyrime financiare dhe kredi të marra nga ana e b/shortes së subjektit pranë institucioneve financiare të sipërcituara.

14. Analiza financiare

SUBJEKTI I RIVLERESIMIT: ASLLAN XH. BARJAMAJ											
PERSHKRIMI	14.11.07 - 31.12.07	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	TOTAL
PASURI	-64,750	-25,646	275,655	-324,005	121,736	141,621	-67,860	-88,090	584,078	5,703,907	6,256,646
Apartment 87 m2, Fier - 45,000€ - 2016										6,087,150	6,087,150
Automjet **** - 2015 - E.B.									150,000		150,000
Ndryshim ne likuiditet	-64,750	-25,646	275,655	-324,005	121,736	141,621	-67,860	-88,090	434,078	-383,243	19,496
DETYRIME	0	55,330	439,227	-93,737	261,094	-158,972	-209,011	-204,790	259,683	5,361,855	5,710,679
Kredi Raiffeisen - 72,000 leke - 2008 - Asllan Barjamaj		55,330	-55,330								0
Kredi Raiffeisen - 500,000 leke - 2009 - Asllan Barjamaj			494,557	-494,557							0
Kredi Raiffeisen - 711,633.61 leke - 2010 - Asllan Barjamaj				700,820	-58,008	-69,070	-83,471	-101,130	-389,141		0
Kredi Raiffeisen - 700,000 leke - 2015 - Asllan Barjamaj									616,755	-122,752	494,003
Kredi Raiffeisen - 4,160,000 leke - 2016 - Asllan Barjamaj										4,091,378	4,091,378
Kredi Raiffeisen - 68,108.07 leke - 2008 - E.B.		0									0
Kredi Raiffeisen - 37,900 leke - 2015 - E.B.									32,070	-18,471	13,598
Kredi NOA - 350,000 leke - 2011 - Asllan & E.B.					319,102	-89,902	-125,540	-103,660			0
Kredi iute Credit - 100,000 leke - 2016 - E.B.										59,000	59,000
Huadhenie F. S. - 2010				-300,000							-300,000
Huamarrje nga B. Z. - 10,000 euro pe blerje shtepie ne Fier										1,352,700	1,352,700
PASURI NETO (PASURI - DETYRIME)	-64,750	-80,975	-163,572	-230,268	-139,358	300,593	141,151	116,699	324,395	342,053	545,967
TE ARDHURA dokumentuar	105,962	986,292	1,234,085	1,557,271	1,536,025	1,133,123	1,304,898	1,583,946	1,720,058	2,198,298	13,359,958
Te ardhura nga puna subjekti Asllan Barjamaj	105,962	792,498	1,057,841	1,109,762	1,045,411	934,620	897,939	1,220,350	1,190,378	1,536,066	9,890,827
Te ardhura nga puna b/shortja E.B.		193,794	176,244	433,109	490,614	198,503	406,959	363,596	529,680	532,232	3,324,731
Te ardhura nga interesat e depozites ISP - b/shortja				14,400							14,400
Te ardhura nga shitje automjeti *** - 2016										130,000	130,000
SHPENZIME	30,278	709,328	967,097	721,146	1,010,314	762,778	847,339	1,108,075	1,162,105	1,684,813	9,003,273
Shpenzime jetese	17,078	284,625	409,860	409,860	409,860	418,644	564,096	879,992	897,104	940,368	5,231,487
Shpenzime interesa kredi RFZ - 72,000 leke - 2008 - subjekti		3,332	4,697								8,029
Shpenzime interesa kredi RFZ - 500,000 leke - 2009 - subjekti			9,515	74,261							83,776
Shpenzime interesa kredi RFZ - 711,633.61 leke - 2010 - subjekti				19,025	120,819	108,388	91,761	70,227	6,920		417,140
Shpenzime interesa kredi RFZ - 700,000 leke - 2015 - subjekti									77,644	70,743	148,386
Shpenzime interesa kredi RFZ - 4,160,000 leke - 2016 - subjekti										82,630	82,630
Shpenzime interesa kredi RFZ - 68,108.07 leke - 2008 - b/shortja		2,771									2,771
Shpenzime interesa kredi RFZ - 37,900 leke - 2015 - b/shortja									1,537	3,632	5,170
Shpenzime interesa kredi NOA- 350,000 leke - 2011 - subjekti					48,677	68,597	47,482	13,856			178,612
Shpenzim per perdorim dhe blerje automjeti *** & ***		200,000	345,025								545,025
Shpenzime shendetesore				50,000							50,000
Shpenzim per blerje kompjuter dhe laptop		70,000							34,900	80,000	184,900
Shpenzime qiraje		105,000	198,000	168,000	164,000	142,000	144,000	144,000	144,000	144,000	1,353,000
Shpenzime transporti nderqytetas	13,200	43,600			231,000						287,800
Shpenzime mobilimi, elektroshtepiake, etj. shtepia Fier						35,958	25,150			363,440	363,440
Shpenzime udhetimi											61,108
Analiza dokumentuar	140,435	357,940	430,560	1,066,393	665,070	69,752	316,407	359,172	233,558	171,432	3,810,718
										Pamundesit financiare totale	0

Në përfundim të hetimit, Komisioni doli në konkluzionin se, nga analiza financiare subjekti dhe b/shortja e tij kishin mundësi financiare të mjaftueshme për shtimin e pasurive, likuiditeteve dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera të periudhës 14.11.2007 - 31.12.2016.

15. METODOLOGJIA

Kjo analizë financiare, mund të jetë objekt ndryshimi në varësi të provave dhe shpjegimeve të subjektit për këto rezultate hetimi si dhe vlerësimin përfundimtar nga Komisioni.

Gjatë kësaj analize, Komisioni është bazuar në:

a. Gjendjet e likuiditeteve të subjektit dhe b/shortes, të nxjerra nga dokumentet bankare të kërkuara nga: BKT, Raiffeisen Bank, Credins Bank, ProCredit Bank, NOA, Tirana Bank, Intesa SanPaolo Bank, Otp Bank si dhe gjendjet cash të deklaruara nga subjekti.

b. Të ardhurat e ligjshme, ku përfshihen:

(i) Të ardhurat nga pagat e subjektit si: prokuror në Prokurorinë e Gj. Shkallës I Vlorë (2007 – 2008), prokuror në Prokurorinë e Gj. Shkallës I Gjirokastrë (2008 – 2011), prokuror në Prokurorinë e Gj. Shkallës I Përmet (2011 – 2016)

(ii) Të ardhurat nga bashkëshortja e subjektit: Bashkia Patos (2006 – 2007), Drejtoria e Shërbimit Social Shtetëror Fier (2008), Bashkia Gjirokastrë (2010) Shtëpia e të Moshuarve Gjirokastrë (2010 – 2011), Drejtoria Arsimore Përmet (2012 – 2016), Gjykata e Rrethit Gj. Përmet (2012).

(iii) Të ardhurat e b/shortes nga interesat bankare tek ISP Bank,

(iv) Të ardhura nga shitja e automjetit tip *** (2016)

Nuk janë përfshirë në analizën financiare, të ardhurat e pretenduara nga subjekti si pedagog pranë Universitetit ***, dega Përmet sepse nuk vërtetohet me dokumentacion marrja këtyre të ardhurave (mandate ose transfertat bankare) dhe as pagesa e detyrimeve tatimore për to. Dokumentacioni i sjellë nga subjekti gjatë hetimit, nuk është në formën e kërkuar nga ligji.

Nuk janë përfshirë në analizën financiare, të ardhurat e pretenduara nga b/shortja e subjektit si eksperte/psikologe pranë Gjykatës së Gjirokastrës dhe Përmetit, të cilat nuk janë vërtetuar me me dokumentacion provues.

c. Shpenzimet, ku përfshihen:

(i) Shpenzimet e jetesës bazuar në shpenzimet mujore për konsum sipas madhësisë së familjes, (anketa e buxhetit të familjes nga INSTAT);

(ii) Shpenzime për blerje pajisje elektroshtëpiake dhe mobilim (2016), sipas deklarimit të subjektit në përgjigje të pyetësorit standart dhe provave dokumentare të kontratave të kredive.

(iii) Shpenzime qiraje 2008 - 2016, sipas deklarimit të subjektit në përgjigje të pyetësorit standart.

(iv) Shpenzimet për blerje automjet tip **** (2008) dhe tip *** (2009) sipas deklarimit të subjektit në pyetësor dhe në prapësime.

(v) Shpenzime shëndetësore (2010) sipas deklarimit të subjektit në përgjigje të pyetësorit standart.

(vi) Shpenzime për blerje pajisje kompjuterike (2008, 2015, 2016) sipas deklaramit të subjektit në përgjigje pyetsori

(vii) Shpenzime interesi dhe komisione si dhe për shlyerje principali për kreditë e marra nga subjekti dhe b/shortja tek Raiffeisen Bank, NOA, dhe IuteCredit Albania sipas vërtetimeve dhe statement bankare përkatëse (2008 – 2016).

(viii) Shpenzime transporti ndërqytetas sipas deklaramit të subjektit në përgjigje pyetësori

(ix) Shpenzime udhëtimi për të cilat janë marrë të dhëna nga sistemi TIMS. Për përlllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit është zbatuar vendimi nr. 11/2019 (J.R.) dt. 22/05/2019 i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Nuk janë marrë në konsideratë shpenzimet e udhëtimit kur subjekti/ bashkëshorti kanë deklaruar e dokumentuar udhëtime për qëllime pune dhe ato për të cilat janë dokumentuar qëndrim pranë njerëzve të afërm.

- d. Në vlerat e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, bazuar në kontratat e sipërmarrjeve/ shitblerjeve të këtyre pasurive³⁰.
- e. d. Huamarrje nga shtetasi B. Z për blerje apartamenti sipas kontratës së huadhënies (2016)
- f. e. Huadhënie shtetasit F.S (2010) sipas deklaramit të subjektit në DPV 2010 dhe në përgjigje pyetësori.

Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit:

Komisioni, në vlerësimin e çështjes në lidhje me kriterin e pasurisë, bazuar në provat që disponon, si dhe bindjen e brendshme, çmon se, se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaramit të mjaftueshëm për pasuritë e krijuara, si dhe justifikon me burime të ligjshme krijimin e tyre, duke zbritur dhe shpenzimet e jetesës, sipas përcaktimeve të germës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

B. VLERËSIMI I FIGURËS

- DSIK si Institucioni kompetent për kontrollin e figurës, verifikimit të deklarimeve të subjektit dhe të dhënave të tjera, me qëllim përcaktimin nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me krimin e organizuar, në përputhje me nenin 39, të ligjit 84/2016, ka dërguar pranë KPK raportin³¹ për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Asllan Barjamaj.
- Me shkresën³² e dërguar në vitin 2017, DSIK-ja ka përcjellë raportin mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Asllan Barjamaj, me konstatimin për përshtatshmëri në vazhdimin e detyrës.
- Komisioni i kërkoi DSIK përditësimin dhe deklasifikimin e raportit për subjektin A.Barjamaj³³.
- DSIK-ja në raportin³⁴ e përditësuar dhe deklasifikuar plotësisht konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit z. Asllan Barjamaj.
- Pas këtij raporti DSIK-ja ka dërguar një raport³⁵ tjetër po në të njëjtën datë të deklasifikuar pjesërisht, ku konstatohet se për subjektin e rivlerësimit z. Asllan Barjamaj, disponohen të dhëna për përfshirje në veprime korruptive shfaqur në formën e shpërdorimit të detyrës. Në këtë raport

³⁰ Shih kontratat e shitjeve për pasuritë e paluajtshme, në dosjen e ILDKPKI-së.

³¹ Shih raportin përfundimtar të DSIK-së dërguar me shkresën me nr. *** prot., datë 01.09.2022, deklasifikuar pjesërisht me vendim të KDZH, numër *** datë 25.08.2022.

³² Shih raportin dërguar nga DSIK-ja me shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2017.

³³ Shih kërkesën nr. *** prot., datë 6.6.2022 të KPK drejtuar DSIK-së.

³⁴ Shih raportin e deklasifikuar plotësisht me vendim nr. ***, datë 25.08.2022.

³⁵ Shih raportin e deklasifikuar pjesërisht me vendim nr. ***, datë 25.08.2022 të KDZH-së.

theksohet se informacionet e ardhura nga ana e autoriteteve verifikuese për subjektin e rivlerësimit Asllan Barjamaj janë të dhëna që nuk janë sqaruar apo thelluar më tej dhe nuk kanë patur vijueshmëri.

➤ Në përfundim DSIK konstaton që, *për rastin në fjalë konkluzioni të mbetet në vlerësimin e Komisionit nën dritën e informacioneve të tjera që mund të dispononi si pjesë e gjetjeve/konstatimeve të dala nga procedurat e hetimit administrativ që po kryhen ndaj subjektit të rivlerësimit.*

➤ Komisioni kreu një hetim të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetit të subjektit të rivlerësimit, përfshirë edhe verifikimin e informacioneve të dërguara nga agjencitë ligjzbatuese.

➤ Në përfundim të hetimit administrativ, referuar edhe informacioneve dhe dokumentacionit të trajtuar nga Komisioni, u arrit në konkluzionin se, për subjektin Asllan Barjamaj nuk u gjetën elementë që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e subjektit në veprimtari të kundraligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh, të Aneksit të Kushtetutës.

Vlerësimi i Komisionit për kriterin e figurës:

➤ Komisioni në përfundim vlerësoi se, subjekti i rivlerësimit z. Asllan Barjamaj ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të gërmës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Raporti për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit A.Barjamaj është përgatitur bazuar në ligjin nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe në ligjin nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Në këtë raport janë analizuar të dhënat duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit:

- a) Aftësitë profesionale;
- b) Aftësitë organizative;
- c) Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale dhe
- q) Aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

Raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizën e: i) Formularit të vetëdeklarimit si dhe të 4 (katër) dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit; ii) 5 (pesë) dosjeve penale, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe bazuar në iii) të dhënat nga burimet arkivore të Sektorit të Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme, struktura të tjera të Prokurorisë së Përgjithshme dhe ato të administruara nga Prokuroritë Pranë Gjykatave të Shkallës së Parë në Republikën e Shqipërisë.

Në lidhje me përvojën profesionale në 10 vitet e fundit, konstatohet se për periudhën 20.11.2007 deri në muajin nëntor 2008, prokurori Asllan Barjamaj, ka kryer në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë stazhin profesional, në ndjekje të programit të forrnimit fillestar si kandidat për magjistrat, profili prokuror. Pas përfundimit të stazhit, duke filluar nga data 21.11.2008 deri më datë 21.02.2011, subjekti i rivlerësimit, ka ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë Pranë Gjykatës si Shkallës së Parë Gjyrokastër. Nga data 21.02.2011 deri në datën 15.07.2016 subjekti është transferuar me detyrën e prokurorit në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet, të cilën e ka ushtruar deri më datë 15.07.2016, si dhe është promovuar në pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë, detyrë të cilën ka vijuar ta ushtrojë deri në momentin e dorëzimit të deklaratës.

Katër dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit.

1. Dokumenti ligjor: Ankim, datë 16.12.2015, i Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet, ndaj vendimit nr. ***/2015, datë 09.12.2015, të Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet, për çështjen penale nr. ***/2015, në ngarkim të të pandehurit L. K, i akuzuar për veprën penale të "Mashtrimit", parashikuar nga neni 143/1 i Kodit Penal.

2. Dokumenti ligjor: Vendim datë 23.11.2015 "Për pushimin e procedimit penal Nr. ***/2015".

3. Dokumenti ligjor: Kërkesë datë 17.02.2016 "Për gjykimin e procedimit penal nr. ***/2014".

4. Dokumenti ligjor: Kërkesë datë 11.12.2015 "Për gjykimin e procedimit penal Nr. ***/2015".

Nga verifikimi i këtyre 4 praktikave, dokumenteve ligjore nuk u konstatuan problematika lidhur me kriterin profesional.

Përshkrimi i 5 dosjeve të përzgjedhura me short për subjektin e rivlerësimit A. Barjamaj.

Dosja 1. "Vendim për mosfillimin e procedimit penal Nr. ***/2014" datë 09.06.2014, përgatitur nga prokurori Asllan Barjamaj, subjekt rivlerësimi.

Dosja 2. "Vendim për pushimin e procedimit penal nr. ***/2015", datë 18.12.2015, përgatitur nga prokurori Asllan Barjamaj, subjekt rivlerësimi.

Dosja 3. Vendim datë 11.04.2016 "Për pushimin e procedimit penal nr. ***/2015", përgatitur nga prokurori Asllan Barjamaj, subjekt rivlerësimi.

Dosja 4. Kërkesë datë 23.06.2014 "Për gjykimin e procedimit penal nr. ***/2014, përgatitur nga prokurori Asllan Barjamaj, subjekt rivlerësimi.

Dosja 5. Kërkesë datë 10.06.2015 "Për gjykimin e procedimit penal nr. ***/2015, përgatitur nga prokurori Asllan Barjamaj, subjekt rivlerësimi.

Pas verifikimit dhe shqyrtimit të 5 çështjeve të përzgjedhura me short nuk u konstatuan problematika lidhur me vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

Të dhëna nga burime arkivore.

Nga verifikimi i të dhënave nga Prokuroritë e Rretheve dhe Prokuroria e Përgjithshme nuk rezulton që subjekti Asllan Barjamaj:

- Të ketë pasur masa disiplinore.
- Të ketë të dhëna apo indicie të ardhura nga agjensitë ligjzbatuese për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshime në kuptimin penal dhe atë të cënimit të figurës së subjektit të rivlerësimit për përfshirje drejtëpërdrejtë ose indirekt në veprime të dyshimta.
- Të ketë të dhëna të dokumentuara (biseda, foto, vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike) të përfshirjes së tij në kontakte me persona të papërshtatshëm (anëtarë të organizatave kriminale, persona të dënuar penalisht apo persona të dyshuar për kryerjen e veprave penale).
- Të ketë patur ndaj tij, materiale hetimore të regjistruara, procedime penale të pushuara apo pezulluara.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 27.06.2018, konfirmon se ndaj subjektit A.Barjamaj është regjistruar kallëzim penal nr. ***/2018, ku është vendosur mosfillimi i procedimit penal. Në përfundim të verifikimeve të

materialit kallëzues, Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë ka arritur në konkluzionin se nuk gjendemi përpara elementëve të ekzistencës së faktit kriminal të "Korrupsionit pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë", parashikuar nga nenet 319/ç të Kodit Penal.

Spektori Protokoll-Arkiv në Prokurorinë e Përgjithshme, konfirmon se nga kontrolli i ushtruar në Regjistrat e Ankesave, për periudhën 2006-2018, rezultojnë 8 ankesa, për të cilat nuk është filluar procedim disiplinor në adresë të subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes apo si drejtues i prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Përmet.

ANALIZA E GJETJEVE PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT ASLLAN BARJAMAJ:

Subjekti i rivlerësimit, prokurori Asllan Barjamaj ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në dokumentet ligjore (4 katër) të paraqitura prej tij dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ai identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. I kushton rëndësi analizës së normës penale dhe procedurale penale të zbatueshme, duke e lidhur përmbajtjen e saj me akte të tjera ligjore dhe nënligjore.

Prokurori Asllan Barjamaj, subjekt rivlerësimi shfaq aftësi për të hetuar, për të marrë urdhra dhe vendime në ndjekje të procedimeve penale konkrete, në respektim të parashikimeve ligjore. Në rastin kur problematika lidhet me zbatimin e ligjit material, trajton çdo element të veprës penale për të konkluduar në kualifikimin e faktit penal sipas normës penale.

Niveli i arsytimit të akteve të vëzhguara respekton standartin e procesit të rregullt ligjor.

Nga analiza e 5 (pesë) çështjeve të përzgjedhura në short, rezultoi se qëndrimi i tij, shprehet brenda afateve, sipas kërkesave të ligjit procedural penal.

Në analizë të të dhënave të mësipërme, konstatohet se subjekti i rivlerësimit prokurori Asllan Barjamaj është eficient dhe efektiv.

Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, konstatohet se dosjet në përgjithësi janë të administruara rregullisht. Në dosjen 5 të vrojtuar, nuk evidentohet administrimi i urdhrit për regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale, akt procedural i veçantë, normuar në nenin 287/1 të Kodit të Procedurës Penale dhe në udhëzimin e Prokurorit të Përgjithshëm nr.*** datë 21.11.2005 "Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale" i ndryshuar. Administrimi i shpërndarjes së materialeve, si pjesë e punës së tij në cilësinë e titullarit të organit të akuzës në zyrën e prokurorisë Përmet, në aftësitë administruese/drejtuese për të tre vitet, është vlerësuar "Shumë mirë" nga Prokurori i Përgjithshëm.

Nga aktet e përzgjedhura nga vetë subjekti, si dhe nga dosjet e hedhura në short, ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve, është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit. Në dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit prokurorit Asllan Barjamaj për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën e prokurorisë, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

D. DENONCIMET E PUBLIKUT TË MBËRRITURA NË KOMISION

Për subjektin e rivlerësimit janë paraqitur 15 denoncime. Disa nga denoncimet janë të përsëritura dhe gjithsej rezultojnë 10 denoncime për subjektin Asllan Barjamaj.

1. Denoncim i përsëritur i shtetas J.J: nr. * prot., datë 3.2.2020; nr. *** prot., datë 22.6.2020; nr. *** prot., datë 17.11.2020; nr. *** prot., datë 5.1.2021 dhe nr. *** prot., datë 21.9.2021.**

Kjo shtetase ka paraqitur disa denoncime (5 pesë) pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, e cila ankohet ndaj prokurorit A.Barjamaj për shkak se i ka pushuar 100% të kallëzimeve të bëra prej saj. Ankuesja ankohet se, prokurori A. Barjamaj i ka pushuar disa herë procedimin penal nr. *** të vitit 2018 dhe nr. *** të vitit 2020 dhe se, pavarësisht kërkesës së gjykatës për plotësim hetimesh, prokurori përsëri nuk ka plotësuar detyrat e lëna nga gjykata dhe nuk ka thirrë ekspert të ri për të kryer akt ekspertimin e nevojshëm brenda një kohe të caktuar.

Ankuesja bashkëlidhur denoncimeve ka sjellë faqe të para të vendimeve (vendimit të gjykatës së rrethit gjyqësor Përmet datë 22.1.2020, ku përfaqësuese e prokurorisë është një prokurore tjetër dhe vendimit të prokurorisë Përmet datë 1.12.2020, me prokuror subjektin e rivlerësimit), por jo vendimet e plota.

Lidhur me çështjet e ngritura nga ankuesja, subjektit iu kërkua të jepte shpjegime.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, në lidhje me këtë denoncim, subjekti ka shpjeguar se, për denoncimin e përsëritur të çështjeve të ngritura nga shtetasja J. J, subjekti ka prapësuar se, procedimi penal nr. *** i vitit 2018 është hetuar nga një prokurore tjetër dhe kërkesa për pushim çështje është bërë po nga ajo prokurore, por në gjykatë për shkak se prokurorja e çështjes ishte për një periudhë kohe me leje lindje, përfaqësimi në gjykatë është bërë nga subjekti i rivlerësimit. Për këtë çështje pasi janë kërkuar hetime shpesh nga gjykata, me vendimin nr. ***, datë 24.9.2020, gjykata ka vendosur pushimin e çështjes, ku përfaqësues i prokurorisë krahas prokurores S.P. ka qënë edhe subjekti i rivlerësimit A. Barjamaj.

Ndërsa, përsa i përket çështjes me nr. ***/2020, kjo çështje është hetuar nga subjekti për veprat penale të “Falsifikimit të dokumentave” dhe “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga nenet 186 dhe 248 K.Penal dhe pasi janë kryer hetimet është kërkuar pushimi i procedimit penal. Gjykata nuk ka pranuar kërkesat e prokurorit dhe ka kthyer disa herë për hetime dhe pasi janë kryer hetimet i është kërkuar gjykatës të disponojë dhe gjykata ka disponuar me përfundim hetimesh dhe marrjen e një vendimi përfundimtar nga ana prokurorit.

Më konkretisht, bashkëlidhur shpjegimeve përfundimtare subjekti ka sjellë:

- ✓ Kërkesën për pushimin e procedimit penal nr. ***/2020 datë 01.12.2020.
- ✓ Vendimin nr.*** datë 20.1.2021 Gjykatës Shkallës Parë Përmet, i cili nuk ka pranuar kërkesën e Prokurorisë dhe ka vendosur vazhdimin hetimeve.
- ✓ Relacionin e Opgj A.N. datë 31.5.2021 mbi kryerjen e veprimeve hetimore për plotësimin e hetimeve dhe pushimin e procedimit penal nr. ***/2020.
- ✓ Kërkesën për pushimin e procedimit penal nr. ***/2020 datë 10.6.2020.
- ✓ Vendimin nr. *** datë 14.07.2021 Gjykatës Shkallës Parë Përmet, për plotësim hetimesh për procedimin penal nr. ***/2020.
- ✓ Kërkesa për pushim procedimi penal nr. ***/2020, pasi plotësimi të hetimeve të lëna nga gjykata datë 10.12.2021
- ✓ Vendimi nr. *** datë 12.04.2022 të Gjykatës Shkallës Parë Përmet për mospranim kerkese dhe vazhdim hetimesh në drejtimet e përcaktuara nga gjykata.
- ✓ Relacion për ecurinë e hetimeve nga OPGJ B.T., datë 28.7.2022,
- ✓ Kërkesë për zgjatje të afatit hetimor nga Prokuroria Përmet, datë 14.09.2022

Me këtë kërkesë prokurori ka kërkuar shtyrjen e afatit të hetimit sepse, nuk është arritur të caktohet dhe thirret një ekspert për të kryer aktin ekspertimit, detyrë e lënë me vendimin nr. ***, datë 12.4.2022 nga Gjykata e Shkallës së Parë Përmet.

Sipas procesverbalit të datës 9.1.2023, evidentohet se Gjykata nuk ka pranuar këtë kërkesë të prokurorit të çështjes dhe i ka dhënë fund shqyrtimit gjyqësor. Çështja është në shqyrtim gjyqësor, kjo vërtetuar me proces-verbalin³⁶ e seancës së datës 9.1.2023 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet.

Vlerësimi i Komisionit:

Siç duket nga dokumentacioni i listuar, Gjykata e Shkallës së Parë Përmet ka kthyer 3 herë aktet e prokurorisë, me kërkesat për plotësim hetimesh dukë lënë detyra të përcaktuara. Referuar arsytimit të bërë në vendimet e gjykatave (nr. *** datë 20.1.2021; nr. *** datë 14.07.2021 dhe nr. *** datë 12.04.2022), si dhe nga relacionet e përgatitura nga opgj i çështjes, evidentohet se, këto detyra të lëna nga gjykata janë përmbushur dhe janë respektuar afatet proceduriale. Po, për shkak të kompleksitetit të procedimit penal (çështje pronësie), edhe veprimet hetimore duket se ishin komplekse³⁷ dhe të shumëanshme.

Subjekti bashkëlidhur akteve të sipërcituara ka vënë në dispozicion edhe vendimet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ku vërtetohet se, ankesat e përsëritura të denoncueses në adresë të prokurorit A.Barjamaj janë arkivuar³⁸. Në këto kushte, Komisioni doli në konkluzionin se, ankesat e denoncueses në adresë të subjektit të rivlerësimit, pavarësisht përsëritjes e kthimit të akteve për kryerje hetimesh shtesë, sipas detyrave të përcaktuara nga gjykata, nuk mund të merren parasysh në vlerësimin përfundimtar të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, përsakohë nuk u evidentuan rrethana për fakte konkrete, të cilat të krijojnë bindjen se, subjekti ka kryer shkelje ligjore në veprimtarinë e tij, në cilësinë e prokurorit të çështjes.

2. Denoncim i shtetasit N.M me * prot., datë 8.7.2021.**

Ky shtetas denoncon prokurorin Asllan Barjamaj për shkak se ai ka vepruar me keqdashje e me qëllim të caktuar si për procedimin penal nr. ***/2019, ashtu edhe për veprën penale në bazë të nenit nr. 283/2 të Kodit Penal. Sipas denoncuesit, vendimi është i padrejtë, i pabazuar në prova e fakte por vetëm në indicie. Denoncuesi thotë se, me datë 16.10.2019 është ndaluar nga forcat operacionale në hyrje të qytetit të Këlcyrës, ku i është bërë kontroll fizik dhe automjeti dhe nuk i është gjetur asnjë send i paligjshëm, veçse 3350 euro, që i ka deklaruar vetë para se ti bëhej kontrolli. Kjo sasi parash i është sekuestruar, por, ai ka këmbëngulur që të shënoheshin numrat e serive të eurove. I është drejtuar gjykatës Përmet duke e hedhë në gjyq prokurorin A.Barjamaj për moskthimin e sasive të eurove të sekuestruara në datën 16.10.2019. Gjyqtari ka vendosur që këto lekë (euro) të mos i kthehen. Denoncuesi ka dyshimin e fortë se prokurori ka prishur sendin e sekuestruar në datë 16.10.2019 dhe në datë 28.2.2020 prokurori ka lëshuar urdhër arresti për kryerjen e veprës penale “Prodhim dhe shitje të lëndës narkotike”, vepër që denoncuesi pretendon se nuk e ka kryer. Denoncuesi e mbyll denoncimin e tij dukë thënë se, është prej 16 muajsh në paraburgim, i akuzuar nga prokurori A.Barjamaj në mënyrë të padrejtë e të paligjshme dhe kërkon të drejtën e tij.

³⁶ Kopje e proces-verbalit të seancës së datatës 9.1.2023 sjellë nga subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit.

³⁷ Veçanërisht përsëritja e akt ekspertimit të pozicionimit të pronave, objekt çështjeje dhe pyetja e punonjësve dhe drejtuesve të ASHK-së Përmet.

³⁸ Shih vendimet e ILD-së: nr. *** prot., dt. 10.9.2020 dhe nr. *** dt. 26.4.2021.

Sa më sipër, subjektit të rivlerësimit iu kërkua të jepte shpjegime, në lidhje me respektimin e afateve të paraburgimit të denoncuesit, si dhe për vendimet (datë 1.3.2020, 22.10.2020 dhe 4.3.2021), të përmendura nga ankuesi.

3. Denoncim i shtetasit E.B me * prot., datë 14.7.2021.**

Ky shtetas denoncon prokurorin Asllan Barjamaj dhe kërkon që padrejtësitë të shqyrtohen nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe të merren masa ndaj përgjegjësive të tyre. Aktualisht denoncuesi thotë se, është në paraburgim IEVP Lezhë pasi është arrestuar më dt 23.12.2019, akuzuar për veprën penale “prodhim dhe shitje narkotikësh”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 283/2 i K.Penal. Më datë 27.12.2019 Gjykata e Lezhës ka caktuar masën e sigurimit “arrest me burg”, me afat 90 ditor. Afati i kësaj mase sigurie mbaronte në datën 27.3.2020, ndërsa ai është mbajtur në burgim deri në datë 13.4.2020 pa vendim gjykate, pa zhvilluar asnjë seancë gjyqësore dhe pa marrë dijeni për zgjatje të afatit të paraburgimit. Prokuroria e rrethit Përmet ka kërkuar “arrest me burg” duke zhvilluar seancë gjyqësore me gjykatën pa dijeninë e denoncuesit dhe të avokatit të tij mbrojtës, si dhe pa qënë kompetencë e tyre sepse dosja ka qënë në Prokurorinë e Posacme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar që nga data 6.4.2020, ndërsa seanca gjyqësore është zhvilluar më datë 13.4.2020. Më datë 8.12.2020 prokurori A.Barjamaj është paraqitur në IEVP Lezhë ku është përpjekur ta mashtrojë me pyetjen, “*a je i kënaqur që hetimet ti mbyll për veprën penale “moskallzim krimi” ?*. Po këtë ditë prokurori është paraqitur në IEVP pa vënë në dijeni avokatin mbrojtës të denoncuesit.

Siç shihet nga përmbajtja e ankesës në lidhje me pretendimin e ankuesit, se dosja që i përkiste çështjes penale në lidhje me veprën penale “prodhim e shitje lëndësh narkotike”, parashikuar nga neni 283/2 i K.Penal nuk ishte kompetencë e prokurorisë Përmet, nuk qëndron sepse referuar nenit 76 e në vijim të K.Pr.Penale, i ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, është përcaktuar kompetenca lëndore dhe tokësore e shqyrtimit të çështjeve penale nga gjykatat e rretheve gjyqësore si dhe Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. Në referim të këtij argumenti ligjor dosja që i përkiste kësaj çështjeje ishte kompetencë e prokurorisë Përmet.

Por, subjektit të rivlerësimit iu kërkua të jepte shpjegime nëse ka respektuar të drejtat procedurale të palëve në këtë proces. Gjithashtu, subjektit iu kërkua të jepte shpjegime në lidhje me kohëzgjatjen e masave të sigurimit dhe llogaritjen e afateve të paraburgimit, thirrjen e personit nën hetim pa prezencën e avokatit mbrojtës dhe zhvillimin e seancës gjyqësore pa praninë e tij dhe të avokatit të tij.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti ka shpjeguar se, në kuadër procedimit penal, nr. ***/2019 dhe nr. ***/2020 janë hetuar N.M, ashtu edhe E.B, duke dhënë shpjegime për këta dy shtetas duke qënë se janë në një proces të lidhur.

Në datë 1.3.2020 është vleftësuar si i ligjshëm arrestimi i N. M, pasi dyshohej për veprën penale “Prodhim dhe shitje të narkotikëve” parashikuar nga neni 283/2 K.Penal. Nga data e regjistrimit të procedimit penal 12.12.2019 deri më datë 4.2.2020, çështja është hetuar nga subjekti i rivlerësimit. Me vendimin nr. ***, datë 13.4.2020, çështja i ka kaluar për kompetencë Prokurorisë pranë Gjykatës së Posacme të Krimeve të Rënda, Tiranë, ku kjo e fundit me vendimin e datës 17.6.2020 ka shpallur moskompetencën lëndore për veprat penale që i atribuohen personave të dyshuar dhe i ka kaluar aktet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet. Çështja është hetuar përsëri nga subjekti. Më datë 22.10.2020, i pandehuri N.M. ka bërë kërkesë për ndryshim mase sigurimi, nga arrest burg në një masë më të butë, kërkesë që i është rrëzuar nga Gjykata e Shkallës Parë Përmet. Në datë 04.03.2021 është vendosur kthimi i akteve për këtë të pandehur dhe disa bashkëpandehur për plotësim hetimesh dhe pasi janë plotësuar hetimet janë dërguar për gjykim, ku i pandehuri N.M. është deklaruar fajtor nga shkalla e parë dhe është gjykuar me akuzën e parashikuar nga neni 283/2 K.Penal, nën masën e sigurimit “arrest me burg”. Në përputhje me

nenin 263/3 e vijues të K.Pr.Penale, në kushtet kur neni 283/2 K.Penal parashikon masë dënimi në maksimum deri 15 vjet burg, është respektuar si afat hetimi- afati 1-vjeçar për veprën për të cilin akuzohet dhe këto pretendime të këtij shtetasi janë bërë objekt gjykimi³⁹ nga gjykata dhe janë rrëzuar, duke u rrëzuar gjithashtu edhe nga ILD-ja⁴⁰.

Në datë 23.12.2019 E. B është arrestuar nga forcat operacionale në qytetin e Lezhës dhe dosja fillimisht i ka kaluar Prokurorisë Lezhë, e cila ka vendosur masë sigurimi “arrest me burg” me afat 3 muaj. Në datë 28.2.2020 është bërë përfundimi i hetimit të procedimit penal nr. ***/2019, ku përfshihej edhe E.B, dhe Prokuroria Lezhë ka dërguar aktet për kompetencë Prokurorisë Përmet, të cilat janë pranuar dhe menjëherë është bërë verifikimi i masës së sigurimit, ku gjykata ka vendosur konstatimin e shuarjes së masës së sigurimit “arrest me burg me afat” dhe vendosjen e masës sigurimit “arrest me burg pa afat”, masë me të cilën është gjykuar dhe në shkallë të Parë. Në përputhje me nenin 263/3 e vijues K.Pr.Penale, në kushtet kur neni 283/2 K.Penal parashikon masë dënimi në maksimum deri 15 vjet burg, është respektuar si afat i hetimi- afati 1-vjeçar për veprën për të cilin akuzohet dhe këto pretendime të këtij shtetasi janë bërë objekt gjykimi nga gjykata dhe janë rrëzuar, duke u rrëzuar gjithashtu edhe nga ILD-ja. Gjatë gjithë kohës i pandehuri E.B. ka qënë përfaqësuar nga avokat M.Ll. dhe disa avokatë të tjerë dhe kërkimet e tyre në gjykatë janë rrëzuar.

Referuar vendimit nr. ***, datë 4.2.2020 gjyqtari i çështjes nuk ka disponuar me kthimin e sendit të sekuestruar N.M, të sasisë prej 3350 euro, duke argumentuar se, ato janë sekuestruar në cilësinë e provës materiale dhe si të tilla nuk mund të kthehen (veçanërisht në këtë fazë procesi).

Sipas vendimit nr. ***, datë 13.4.2020 E.B dhe I.R. i janë drejtuar gjykatës me kërkesën për shuarje mase sigurimi dhe njëkohësisht prokuroria (përfaqësuar nga prokurori A.Barjamaj) ka kërkuar rivlerësimin e masës së sigurimit për shkak se, çështja vinte nga një prokurori e një rrethi tjetër dhe ka shpallur moskompetencën duke e dërguar çështjen pranë GJKKO-së.

Më datë 4.3.2021 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet (gjyqtari i seancës paraprake ka rrëzuar kërkesën e prokurorit A.Barjamaj për, *Dërgimin e çështjes për gjykim në ngarkim të 16 të pandehurve* (ndër ta edhe E.B dhe N.M) me argumentimin se, *duhet të plotësohen brenda tre muajve detyrat e lëna nga gjykata për plotësim hetimesh duke i specifikuar (duke kërkuar ballafaqimin e të bashkëpandehurve dhe evidentimin e rolit të gjithësecilit prej tyre).*

Më datë 9.6.2021 (pas kalimit të afatit tre muajor të hetimeve), gjykata e rrethit gjyqësor Përmet, gjyqtari i seancës paraprake ka pranuar kërkesën e prokurorit A.Barjamaj për, *-Dërgimin e çështjes për gjykim në ngarkim të 16 të pandehurve* (ndër ta edhe E.B dhe N.M), dhe referuar proces-verbalit të çështjes gjyqësore, të datës 1.2.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, në ngarkim të 16 të pandehurve ka rezultuar se, të pandehurit E.B dhe N.M janë dënuar përkatësisht me nga 8 vjet dhe 7 vjet burgim për kryerjen e veprës penale “Prodhim dhe shitje narkotikësh”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 283/2 të K.Penal.

Prokurori ka kryer hetimet e plota në drejtim të detyrave të lëna nga gjyqtari i seancës paraprake të datës 4.3.2021.

³⁹ Subjekti ka bashkëlidhur aktet e Gjykatës Shkallës Parë Përmet

⁴⁰ ILD duket se ka vendosur mosshqyrtimin e ankesave të disa prej bashkë të pandehurve në proces ku janë edhe E.B. dhe N. M. të pandehur, por jo ankesat e këtyre dy të fundit. Megjithatë, Komisioni e konsideroi këtë vendim të ILD për të parë tipin e ankesave të personave në një proces të përbashkët.

Vlerësimi i Komisionit:

Në lidhje me pretendimin e denoncuesit E.B, nga analizimi i permbajtjes së dokumenteve shpresore evidentohet se, prokurori i çështjes A.Barjamaj ka njoftuar akuzën, ka komunikuar vendimin e marrjes si të pandehur personave nën hetim N.M dhe E. B dhe ka zhvilluar gjyqin në prani të avokatëve të tyre. Ndërsa në lidhje me kohëzgjatjen e masave të sigurimit dhe llogaritjen e afateve të paraburgimit, gjykata nuk është shprehur me vendim, ku të pranonte këto kërkesa të denoncuesve.

Komisioni arrin në konkluzionin se, nuk kemi të bëjmë me mosrespektim të të drejtave procedurale të të pandehurve në referim të nenit 34/a të Kodit të Procedurës Penale.

Ndërsa në lidhje me pretendimin e subjektit se, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka rrëzuar ankesat e denoncuesve N.M dhe E. B., ai ka parasysh në fakt ankesën e bashkë të pandehurve në këtë proces penal të ndjekur prej tij dhe ku ILD me vendimet nr. *** datë 31.3.2022 dhe me vendimin nr. *** datë 25.7.2022 ka vendosur arkivimin e ankesës së paraqitur nga disa shtetas me iniciale F.H., A.M., A. S. dhe A.T. (bashkë të pandehur me N.M dhe E.B.) ndaj magjistratit A. Barjamaj. Komisioni vlerësoi se, subjekti i rivlerësimit nuk mund ta sillte si dokumentacion praktikën e ILD-së të cituar më lart, lidhur me mosshqyrtimin e ankesave të disa prej bashkë të pandehurve në proces ku E.B. dhe N. M. (të pandehurit- shtetas-ankues) nuk kanë qënë palë ankuese pranë ILD-së. Megjithatë, Komisioni e konsideroi këtë vendim të ILD-së, për shkak se, ankesat lidhen me të njëjtë grup shtetasish të interesuar, për të njëjtin shkak ligjor, dhe për këtë arsye referuar vendimmarrjes së ILD-së për këto ankesa, e konsideroi këtë përgjigje të ILD-së në favor të subjektit të rivlerësimit.

Në përfundim të analizës së provave dhe shpjegimeve të paraqitura nga subjekti, Komisioni vlerësoi se, subjekti arriti të argumentonte bindshëm kryerjen e veprimeve të tij në cilësinë e prokurorit për këto dy denoncime të këtyre dy shtetasve. Nuk u evidentua se, subjekti i rivlerësimit në cilësinë e prokurorit të çështjes, të ketë kryer shkelje ligjore në aspektin procedural përgjatë hetimit të kësaj çështjeje.

4. Denoncim i shtetasit Dh S.S me * prot., datë 15.7.2019.**

Ky shtetas denoncon prokurorin Asllan Barjamaj në lidhje me një procedim penal të vitit 2015 për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga n. 248. i K.Penal ndaj punonjësve të Drejtorisë së Urbanistikës së Bashkisë Fier, i cili pretendon se, edhe në vitin 2013 ka bërë kallëzim penal ndaj shtetasve B.Z ish-kryetar i Bashkisë Fier, punonjësve të kësaj bashkie si dhe shtetasve A.B dhe G. G të cilët kanë ndërtuar në pronën e tij dy pallate 10 dhe 11 kate në shkelje të hapur të ligjeve në fuqi. Pas hetimit të prokurorisë së rrethit gjyqësor Fier, prokurori i çështjes në atë kohë ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. ***/2015 dhe pas ankimit të tij, me vendimin nr. *** datë 13.3.2017 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka vendosur:Pranimin e kërkesës së denoncuesit dhe shfuqizimin e vendimit të datës 20.6.2016 të pushimit të procedimit penal nr. ***/2015 dhe urdhërimin e prokurorisë për vazhdimin e hetimeve. Pas ankimit të prokurorit, Gjykata e Apelit Vlorë ka lënë në fuqi vendimin e shkallës së parë Fier, por prokurori A.Barjamaj nuk ka kryer hetime të plota dhe të hollësishme në lidhje me detyrat e lëna nga gjykata që të çojë para drejtësisë të gjithë shkaktarët e kësaj padrejtësie.

Duke analizuar vendimin e datës 15.2.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, bashkëlidhur këtij ankimi, i cili ka vendosur: *Rrëzimin e kërkesës së prokurorit A.Barjamaj dhe kthimin e akteve duke qënë se hetimet janë të paplota.....*, Komisioni arrin në konkluzionin se, përsakohë kemi të bëjmë me çështje themeli dhe jo aspekti procedural, nuk mund të hetohet më tej për subjektin e rivlerësimit.

5. Denoncim i përsëritur i shtetasit A.M: nr. * prot., datë 28.12.2017 dhe nr. *** prot., datë 29.12.2017.**

Ky shtetas bashkë me familjarët e tij kanë denoncuar disa subjekte të tjerë dhe gjithashtu edhe subjektin e rivlerësimit Asllan Barjamaj. Ky shtetas bashkë me familjarët e vet janë ankuar pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë në Dhjetor të vitit 2017, të cilët kanë paraqitur kallëzim penal ndaj disa subjekteve, ndër to edhe subjektin e rivlerësimit. KLD ka dalë në konkluzionin se, *nga përmbajtja e kallëzimit, nuk rezultojnë të dhëna konkrete që materializojnë pretendimet kundrejt prokurorit Asllan Barjamaj, por në referim të përmbajtjes së ankesës së shtetasit A.M, datë 30.11.2017 drejtuar Këshillit të Lartë të Drejtësisë, akt i bashkëlidhur kallëzimit penal datë 27.12.2017, konstatohet se, shtetasi A.M ngre pretendime që konsistojnë në zhvillimet përgjatë fazës së gjykimit të një procedimi penal, në të cilin prokurori Asllan Barjamaj, duke filluar nga data 09 tetor 2017 përfaqëson Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier. (Për më tepër shih më sipër trajtimin e kësaj ankesë tek pika, *Të dhëna nga burime arkivore*, regjistri i ankesave në Prokurorinë e Përgjithshme, për periudhën viti 2006-2018, në kreun,-Vlerësimi i Aftësive Profesionale).*

Sa më sipër trajtimi i kësaj çështjeje shihet si gjë e gjykuar dhe nuk mund të hetohet më tej për subjektin e rivlerësimit.

6. Denoncim i shtetasit F.M me * prot., datë 24.10.2018.**

Ky shtetas denoncon edhe prokurorin Asllan Barjamaj krahas një subjekti tjetër (gjyqtare), i cili kërkon nga Komisioni inspektimin e veprimeve e mosveprimeve procedurale të prokurorit A.Barjamaj në lidhje me mosmbrojtjen e vendimit të mosfillimit të procedimit penal nr. *** prot., datë 15.7.2017 dhe mosushtrimin të ankimit përpara Gjykatës së Apelit Vlorë në lidhje me vendimin e vitit 2018 të gjyqtare M.D. Denoncuesi pretendon se prokurori A. Barjamaj nuk ka kryer në mënyrë korrekte punën e tij në mbrojtje të Prokurorisë dhe ka qënë pothuajse inekzistent në sallën e gjykimit.

Pas shqyrtimit të ankimit të shtetasit F.M, Komisioni nuk evidentoi shkelje procedurale në adresë të subjektit të rivlerësimit.

7. Denoncim i shtetasit A.H me * prot., datë 6.11.2018.**

Ky shtetas denoncon disa subjekte rivlerësimi, ndër to edhe subjektin e rivlerësimit Asllan Barjamaj. Nga verifikimi i ankesës dhe vendimeve të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, bashkëlidhur kësaj ankesë, nuk ka indicie që ta lidhin subjektin e rivlerësimit me shkeljet e pretenduara të denoncuesit A.H. Kështu që nuk mund të hetohet më tej për subjektin e rivlerësimit.

8. Denoncim i shtetasit Ç.J me * prot., datë 11.1.2018.**

Ky shtetas denoncon subjektin e rivlerësimit Asllan Barjamaj sepse ka pushuar çështjen e tij pa të drejtë duke mos kryer hetim mbi ngjarjen sepse personi që ai ka kallzuar në prokurori i ka vjedhur pronën dhe për më tepër ai vetë ka qënë vëzhgues në komisionin e ndarjes së tokave dhe ka firmosur aktin e marrjes së tokës. Sipas denoncuesit, personi i kallzuar nuk ka lindur në fshatin Ballaban por ka punuar aty dhe kryetarja e prokurorisë i drejtohet ZVRPP Përmet nëse ka prona ky person, ku ndërkohë i ka falsifikuar në hipotekë. Ky person nuk figuron në parcelën që i është dhënë denoncuesit, fakt të cilin edhe personi i kallzuar e ka pranuar. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë dhe e Apelit i kanë dhënë të drejtë denoncuesit.

Duke parë edhe dokumentacionin bashkëlidhur këtij denoncimi, veçanërisht vendimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së parë Përmet “Për mosfillimin e kallëzimit penal nr. ***/2015 për v.p. Falsifikimi i dokumenteve, parashikuar nga neni 186 i K.Penal” të datës

13.5.2015, Komisioni vlerësoi se, vendimmarrja e prokurorit A.Barjamaj ka qënë objekt ankimi në gjykatë, çka vërtetohet me ankimin e ushtruar (brenda afatit ligjor) nga ankuesi pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, si dhe me vendimin nr. ***, dt.15.10.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë (ku ankuesi i drejtohet Gjykatës me kërkesën për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të AMTP në lidhje me problemin e mbivendosjes). Dhe rezultoi se kjo gjykatë ka pranuar kërkesën e tij duke i dhënë zgjidhje problemit të mbivendosjes së parcelave të tokës, objekt konflikti. Në këto kushte nuk mund të hetohet më tej për subjektin e rivlerësimit.

9. Denoncim i shtetasit A.B me * prot., datë 30.7.2018.**

Ky shtetas denoncon disa subjekte rivlerësimi (gjyqtarë e prokurorë), ndër to edhe subjektin e rivlerësimit Asllan Barjamaj. Qytetari A.B denoncon në cilësinë e anëtarit të Këshillit të Bashkisë Këlcyrë duke i kërkuar Komisionit që të shikojë vendimet e pushimit të prokurorisë dhe vendimet e gjykatave të të gjitha shkallëve, ti shqyrtojë ato, se sa të njëanshme dhe jo profesionale janë.

Në dokumentacionin bashkëlidhur që denoncuesi ka sjellë, ka një sërë aktesh ligjore: vendime nga gjykata të ndryshme dhe vendime të organit të prokurorisë, nga ku subjekti i rivlerësimit ka ushtruar funksionin e tij. Nga studimi i tërë akteve që ankuesi ka sjellë evidentohet qartësisht se ai nuk ka qënë palë e dëmtuar nga faktet e kallëzuara prej tij në lidhje me shpërdorimin e detyrës nga ana e funksionarëve dhe punonjësve të Bashkisë Këlcyrë, si dhe këto fakte nuk përmbushin kërkesat e nenit 281 të K.Pr. Penale.

Ndërsa, nuk u evidentuan shkelje procedurale nga ana e subjektit të rivlerësimit në cilësinë e prokurorit.

10. Denoncim i shtetasit Dh.Q me * prot., datë 12.12.2017.**

Ky shtetas i është drejtuar shumë insitucioneve kushtetuese e organeve të drejtësisë, i cili ankohet se, gjyqi është bërë i manipuluar, i korruptuar, i njëanshëm sepse ka sunduar paraja e E.Z.C, për shkak të zyrtarëve të korruptuar e të pandërgjegjshëm të cilët kanë grabitur tokën e fituar në bazë të ligjit nr. 7501 “Për Tokën”. Ndërsa për subjektin e rivlerësimit Asllan Barjamaj, denoncuesi pretendon se, ai e ka manipuluar gjyqin dhe e ka kthyer në favor të E.C sepse prej tij është shpërblyer mirë.

Sa më sipër, por edhe letra (ankesa) të tjera të tij përsërisin të njëjtat pretendime për shumë funksionarë e subjekte, pa saktësuar akte konkrete gjyqësore apo të prokurorisë, ku mund të ndalonte hetimi ynë. Në këto kushte, nuk mund të hetohet më tej për subjektin e rivlerësimit A.Barjamaj.

Gjetje të tjera:

Nga indicie të mbërritura pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit në lidhje me ushtrimin e funksionit si gjyqtar të subjektit të rivlerësimit Asllan Barjamaj, Komisioni i është drejtuar organit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier me kërkesën me nr.*** prot., datë 11.1.2023 për kopje të dosjes së procedimit penal të vitit 2018, për shtetasin J. H.

Me shkresën nr. *** prot., datë 17.01.2023, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier ka dërguar pranë KPK-së kopje të dosjes së **procedimit penal nr. *** të vitit 2017**, i cili është dërguar për gjykim në datë 29.12.2018, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier.

Rrethanat e faktit: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier ka rregjistruar procedimin penal nr. *** në muajin Qershor të vitit 2017, i cili bën fjalë për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, “Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose vizave”, “Falsifikimi i monedhave”, parashikuar nga nenet 183/2, 186/2 dhe 189 të Kodit Penal. Rregjistrimi i procedimit penal është bërë bazuar në informacionin e datës 22.6.2017 të shërbimeve të Policisë

Gjyqësore ku rezulton se, ka informacione se, shtetasi J. H (një ndër disa personat e dyshuar) falsifikojnë kontrata shitblerje, dokumente automjetesh, monedha, patenta shqiptare dhe të huaja për shumën 150 euro etj.

Vërtetohet se, J.H ka falsifikuar dy leje drejtimi, një kartëmonedhë 100 euro në bashkëpunim me B. H. dhe S. P. Në vitin 2016 ka hedhur në qarkullim bashkë me S.P. dhe B.H. shumën prej 50,000 lekë të falsifikuara dhe në bashkëpunim me B.H. ka blerë në Dubrovnik me kartë monedha të falsifikuara një automjet me ngjyrë të bardhë. Në bashkëpunim shtetasin E.D. dhe S.P. kanë falsifikuar dokument leje drejtimi Rumune për një shtetase Rumune.

Më datë 29.12.2018, prokurori A.Barjamaj kërkon kalimin për gjykim të procedimit penal në ngarkim të 11 të pandehurve, ndër to edhe të J.H, ku ky i fundit akuzohet për kryerjen e veprave penale të sipërcituara. 11 personat e dyshuar janë hetuar nën masën e sigurimit “arrest ne burg”, “arrest në shtëpi”, dhe “detyrim për paraqitje”. J.H është hetuar nën masën e sigurimit shtrëngues personal “arrest ne burg” nga data 10.3.2018 deri 7.5.2018 dhe pastaj “arrest në shtëpi” deri në datën 16.5.2019, kur Prokurori A.Barjamaj ka kërkuar kalimin për gjykim të procedimit penal nr. ***, sipas akuzave të ngritura për 11 të pandehurit. Ndërsa, çështja më pas është ndjekur nga prokurori Ç.S, i cili në cilësinë e prokurorit të çështjes ka kërkuar dënimin e J.H për veprat penale “Falsifikimit të kartëmonedhave”, parashikuar nga nenet 183/2 të K.Penal dhe “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/2 të Kodit Penal dhe dënimin përfundimtar (pas aplikimit të gjykimit të shkurtuar) me 4 vjet burgim. Vendimi mban datën 7.10.2019.

Duke parë dispozitat e K.Pr.Penale, respektivisht nenet 228, 229 dhe 230 që kanë të bëjnë me kushtet dhe kriteret e caktimit të masave të sigurimit personal me karakter shtrëngues, vërehet se, prokurori Asllan Barjamaj ka kërkuar dhe ka pranuar ndryshimin e masës së sigurimit “arrest me burg” me një masë më të butë, siç është ajo “arrest në shtëpi” për personin nën hetim J.H.

Për gjetjen e bërë si pjesë e rezultateve të hetimit, subjektit të rivlerësimit iu kërkuar të jepte shpjegime, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, në lidhje me gjetjet e tjera, për rastin e procedimit penal nr. */2017, subjekti ka shpjeguar si vijon:**

Fillimisht ky procedim penal është rregjistruar me nr. ***/2017 për veprat penale: “Falsifikimi i dokumenteve”, “Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose vizave”, “Falsifikimi i monedhave”, parashikuar nga nenet 183/2, 186/2 dhe 189 të Kodit Penal.

Për këtë procedim penal janë kryer veprime proaktive dhe ka qënë rasti parë, ose operacioni i parë në kuadër të “Forca e ligjit” e vitit 2017, arritur nga Prokuroria Pranë Gjykatës Shkallës Parë Fier dhe në rang Republike, nga gjitha prokuroritë, me një numër mbi 30 persona në hetim.

Me vendimin nr. ***, date 12.03.2018 të Gjykatës Shkallës Parë Fier, është bërë verifikimi i masës së sigurimit “arrest me burg” për personin nën hetim J.H. Në datë 07.05.2018, kërkuesi J.H dhe mbrojtësi i tij kanë bërë kërkesë për zvendësim mase sigurimi. Nga ana e subjektit dhe mbështetur nga Gjykata, mbrojtësi dhe i arrestuari, kanë pretenduar se kanë probleme të theksuara shëndetsore dhe kanë paraqitur, ndër të tjera, prova shkresore dhe akte mjeko ligjore, të cilat janë kërkuar nga subjekti dhe gjykata i ka pranuar duke i marrë si provë⁴¹. Në proces gjyqësor, Gjykata ka administruar, aktin e ekspertimit mjeko-ligjor me nr. *** ku, përcaktohet se, i arrestuari vuan nga diabeti dhe ka çrregullime të ritmit të zemrës. Gjykata ka thirrë ekspertin në seancë dhe përfundimet janë pasqyruar në pikat 5,6,7 të vendimit nr. *** datë 07.05.2018. Subjekti ka argumentuar se referuar situatës shëndetsore ekstremisht të rrezikshme, ka zgjedhë të zëvendësojë

⁴¹ Subjekti referon pikën 4 të vendimit nr. *** date 07.05.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, faqe 2.

masën e sigurimit, nga “arrest me burg”, me një masë më të butë, siç është ajo “arrest në shtëpi” dhe për këtë fakt argumenton, se në ato kushte ishte zgjedhja më e mirë për shtetasin nën hetim J.H.

Këto prova, të marra në seancë gjyqësore, që janë cituar në vendim, janë në përputhje me nenin 246/6 K.Pr.Penale që përcakton detyrimin e prokurorit, - “Çdo dy muaj nga zbatimi i vendimit të arrestit, prokurori informon me shkrim gjykatën që ka caktuar masën mbi hetimet e kryera dhe nevojat e sigurimit. Informacioni përmban të dhëna për gjendjen e procedimit, pyetjen e të pandehurit dhe personave të tjerë, përshkrimin e të dhënave të marra dhe shoqërohet me kopje të akteve të fashikullit”. Kur prokurori nuk informon në afatin e përcaktuar, gjykata verifikon nevojat e sigurimit me kërkesë të të pandehurit ose kryesisht. Gjykata, pasi dëgjon palët, vendos vazhdimin, zëvendësimin ose revokimin e masës së sigurimit. Zbatohen rregullat e parashikuara në nenet 248 dhe 249 të këtij Kodi.

Bazuar në nenin 229 K.Pr.Penale, dhe nenin 230/2 K.Pr.Penale, ku përcaktohet se “*Nuk mund të vendoset arresti në burg ndaj një personi që ndodhet në gjendje shëndetësore veçanërisht të rëndë.....*”. Pikërisht bazuar në gjendjen shëndetsore të të pandehurit dhe faktit që mjeku ligjor në seancë pranoi se, gjendja e këtij shtetasi është e rëndë, dhe nga ana e I.E.V.P. Fier ishte shoqëruar disa herë jashtë ambjenteve të institucionit për të marrë ndihmë, është mbajtur ky qëndrim me qëllim për mosjelle ndonjë pasojë për jetën e të dyshuarit në I.E.V.P.Fier dhe ky qëndrim imi është mbështetur dhe nga Gjykata⁴².

Vlerësimi i Komisionit për gjetjen e Komisionit:

Pas shpjegimeve të subjektit, në referim të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, të cilat përcaktojnë kushtet e kriteret e caktimit të masave të sigurimit, dhe të ndryshimit të këtyre masave, si edhe dy vendimeve të cituara prej tij, i cili ka ndryshuar masën e sigurimit personal “arrest me burg”, duke e zëvendësuar atë me një masë më të butë “arrest në shtëpi” për shtetasin nën hetim J.H., Komisioni vlerësoi se, arsyetimi i subjektit në lidhje me këtë veprim të tij është i mjaftueshëm në kuptim të respektimit të dispozitave të K.Pr. Penale, por edhe të të drejtave të personit nën hetim J.H.

Vlerësimi i Komisionit për aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit:

Në përfundim, Komisioni vlerësoi se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të mira në punë, dhe konsiderohet “i aftë”, duke arritur në përfundimin se, subjekti i rivlerësimit ka nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, në kuptim të germës c, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Asllan Barjamaj, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas parashikimit të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

⁴² Shih dokumentet provuese të subjektit: vendimin nr. *** datë 12.03.2018 vendimin nr. *** datë 07.05.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë Fier.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, zj. Marie Tuma, referuar gremës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe në pikën 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Asllan Barjamaj, me detyrë prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Përmet.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 20.2.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Pamela QIRKO
Kryesuese

Roland ILIA
Relator

Brunilda BEKTESHI
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Amela Idrizi